

BUZUKU

numër 28



Revistë informative, kulturore e shoqërore
Ulqin, e enjte më 18 dhjetor 2008, çmimi 1€, 2\$



SHKA "ULQINI" dhe "SHTOJI" në Amerikë, fq.6





Trupi do të falenderoj për mosndezjën e cigarëve

Ostros - një shtëpi e moçme



Foto: S. Dobreci

Jetë e mbushur me brennga, e zbehtë nga tymi dhe e rrethuar me shiringat e dëshpërimit. I mbyllur brenda katër mureve të dhomës ku qëndron e varur ora në të cilën janë të shënuara orët, minutat dhe sekondat. Po ashtu aty brenda sajë ndodhën dhe akrepat që lëvizin me një shpejtësi të madhe, e ty... ty të ka dalë përpara tymi i zbehtë që nuk të lejon të shohësh atë. Çdo ditë, çdo natë, çdo mëngjes, çdo muaj të duket i ngjashëm. Ato vazhdojnë me ritmin e zakonshëm. I ulur në karrigë e mban në dorë cigaren, shijon të hidhurën dhe sulmin e sajë, ndoshta dëshiron të kërkosh diçka më tepër mirëpo ai nuk të lejon. Shpresat janë të zymta, ato kanë vdekur. Koha kalon me shpejtësi e nuk kthen më pas mirëpo kjo për ty është e paparë

dhe vazhdon... përsëri të mbajshë në dorë atë cigare të mallkuar që ta heq monotoninë. Dita e nesërme tek ti nuk sjell diçka të re, as gëzim, as hidhërim. Të tilla janë ditët, netët për ty nuk kanë aspak dallim. Duhani... hipokrit i

Letër prej Italisë

Miq të redaksisë të revistës BUZUKU, z. Simë Gjon Dobreci!

From: Paul Tedeschini
 <paul.tedeschini@yahoo.it> **To:** fdobreci@t-com.me
Date: Sunday, November 16, 2008
 07:02 am **Subject:** Re: Nji pyetje

Jam tue shfletue gazetën tuej e cila

me pëlqen shumë dhe ju baj përgëzime për mbajtjen e sajë. Mendoj të marr pjesë të ndryshme nga kjo gazetë dhe t'i vendos herë mbas herë në gazetën time

[Http://kosova.albemigrant.com](http://kosova.albemigrant.com)

Me vjen mirë që jemi vue në sintoni për bashkëpunim. Kjo do të sjell patjetër frutat e veta. Jam nga Shkodra dhe banoj në Itali. Kam dëshirë të njoh nëpërmjet jush dhe gazetës suaj edhe shqiptarët që janë në Mal të Zi.

Në Budva kam nji mik kosovar argjendar (zltar) që quhet Josif Markoviq dhe që e ka dyqanin në Stari Grad afër Kishes katolike dhe ortodokse. Para disa viteve kam shkue me e takue, por nuk kalova nëpër Ulqin për mungesë kohe. Për sot po përfundoj të kaloni mirë.

Te fala Paul Tedeschini

Kulla e Pizës në Itali



Rri shtremtë e fol nreqtë (popullore)



Foto: S. Dobreci

Gjokë Dabaj dhe Ismail Doda para shkollës Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Ostros

do të shërojnë plagën e duhanit ashtu siç nuk pati ilaç që të shkëpuste ty nga ai. Më mirë do ishte që me kohë të ishe shmangë nga duhani, mirëpo kjo për ty ishte e pamundur. Nuk pate nevojë ta tymosësh kot jetën sepse ajo edhe pa atë tym të zbehtë do mund të ekzistonte.

Jasmine Gjenciqi

klasa VIII-tradicionale, Shkolla fillore "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu", Krajë

PËRMBAJTJA

2. Lexuesit na shkruajnë
3. Gjarprinjtë ruajnë kishën
4. Gjarpri shpëton marinarët
5. Përkujtohet Kongresi i Manastirit
6. Ansambli Ulqini dhe Shtoji në Amerikë
8. Një ditë në Pinç
10. Kleri katolik dhe Kongresi i Manastirit
12. Salçi dikur dhe sot
13. Shasi qytetërim i moçëm
14. Emigrimi shkretoi Amullin
15. Reçasit e duan vendin e vet
16. Shkolla shqipe në Krajë
17. Në Kosiq u bekua Kisha
18. Toponimet e Krythës
20. Vitrina e librit
21. Poezi
22. Popullore
23. Të ndryshme

Buzuku 28

**REVISTË E PËRKOOSHME
INFORMATIVE, KULTURORE
E SHOQËRORE**

Boton:

Shoqata për kulturë " Dom Gjon Buzuku"
Këshilli programor:

Gjergj Pëgjoni, Mr. Rrok Gjollaj,
prim.dr.Gani Karamanaga, prof.dr. Mentor
Disha, prof.dr.Hysni Hoxha, prof.dr.Jahja
Drançolli, Vera Kovaçi, Lekë Brisku, Mitër
Pekaj, Gjystina Dabaj, Gjergj Perkolaj, Zef
Kovaçi, Mark Junku, Gjurë Dabaj, Lubo
Lukiqi

Kryeredaktor:

Simë Gjon Dobreci

Ndihmës i kryeredaktorit

Gjekë Gjonaj

Redaksia:

Mr. Riza Rexha, prof.dr. Ruzhdi Ushaku,
Prof. Dr. Hajrullah Koliqi, Idriz Ulaj, Loro
Markiqi, Ali Gjeçbritaj, Pjetër Ivezaj, dr.Luke
Gjokaj, Kolë Camaj, Zef Lukiqi, Drane
Marvuçiqi, Gjokë Dabaj

Fotoshërbimi:

Foto Studio Ars, Foto Rozafa, Foto Arb, Art
Foto Prishtinë, Foto Bruno

Realizimi artistik:

Fisnik Dobreci & Gazmend Çitaku

Adresa e redaksisë:

Bul. Gjergj Kastrioti Skënderbeu
85360 ULQIN

Nr.tel. ++382 (0) 30 401-384, 069 441-943

www.buzuku.info

E-mail: fdobreci@t-com.me;

Loromark@t-com.me

Numri i llogarisë rrjedhëse

Banka komerciale malazeze A.D.

Ekspozitura Ulqin Nr. 510-0-40

Thirrje ne Nr. 510270393491001825

Revista është rregjistruar në Sekretariatin
Republikan për Informata të Malit të Zi,
nr. 04 / 01- 466

Dorëshkrimet dhe fotografitë nuk kthehen

Gjarpinjtë ruajnë kishën

Në Ljare, katund malor në jug-perëndim të Liqenit të Shkodrës (perëndimi i Kranjës, rrethi i Tivarit), gjendet simboli i gjarpinjve në një gur

shikohet me kujdes, në anën e sipërm të pjesës së shmantë (majtë) ka shenja mjaft të qarta edhe për një gjarpër më të paktën.



Ljare - kisha e vorreve

në murin e Kishës së Vorreve, rreth 1 m mbi tokë dhe po aq shmantë (majtas) prej derës së hyrjes (kur shikohet prej jashtë). Dom Fran Markiqi, meshtari që ka shërbyer shumë kohë në Ljare, thotë së guri me simbolin e gjarpinjve është kthyer në vendin ku edhe ka qenë para tërmetit. Fitohet përshtypja se ky gur është i thyer, se i mungon pjesa e sipërme. Mund të jetë thyer gjatë tërmetit 1979, ose gjatë rinovimit të kishës. Zefi Gjonit Lucit Nojës-Kovaçi ka qëllua me dom Vinçenc

Pse simboli i gjarpinjve në mur të kishës? Shestanasit, si dhe të gjithë shqiptarët në Mal të Zi, besojnë që gjarpri ruan shtëpinë. Gjarpri ruan edhe kishën, gjarpri në rrasa të vorreve ruan shpirtrat. Këto besime për gjarprin janë shumë, shumë të moçme, siç vërtetohet prof. Dr Aleksandër Stipçeviqi, ilirolog, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kroacisë (shih fq.4). Shqiptarët i trashëguan besimet për gjarprin prej Ilirëve, prej paraardhësve të vet, prej stërgjyshave të vet. Ilirët i trashëguan prej paraardhësve të Ilirëve, prej proto-ilirëve, pra prej pellazgëve. Kështu, besimet për gjarprin u ruajtën me mija vjet dhe mbërritën te shqiptarët e sotshëm. E qartë, këto shenja të gjarprit në gur, tregimet, si dhe besimet e shqiptarëve për gjarprin, vërtetojnë që shqiptarët janë popull autokton, me rranxë të thella në këto troje, popull me gjak Ilir. Në lidhje me gjarprin, Aleksandër Stipçeviqi thotë: 'Ky tregim ka rëndësi të madhe për studimin e gjurmëve ilire në besimet e tashme të shqiptarëve rreth Liqenit të Shkodrës; ai mund të na shërbejë edhe si vërtetim jo vetëm për vazhdimësinë kulturore por edhe etnike të shqiptarëve në ato troje'.


Përgatiti Simë Gjon Dobreci



Simboli i gjarpinjve në murin e kishës

Gjarpri shpëton marinarët në Liqe të Shkodrës

Shkruan Aleksandër Stipçeviq*



Aleksandër Stipçeviq

Në besimet e popujve të Ballkanit, gjarpri shpeshherë shfaqet si krijesë që ndihmon njerëzit, që i ruan prej të keqes, që u ruan shtëpitë dhe varret, që përfaqëson shpirtrat e të parëve. Ata besime për gjarprin janë shumë të moçme në Ballkan, sidomos në trevat, të cilat për arsye gjeografike ose ndonjë arsye tjetër, kanë mbetur të kursyera prej ndikimeve të mëdha të popujve të ndryshëm, të cilët gjatë kohës prunë në Ballkan besime dhe adete tjera.

Një prej atyre viseve, që kanë ruajtur shumë besime dhe adete të moçme, është treva në veri të Liqenit të Shkodrës. Saktë, në këtë zonë është ruajtur tregimi shumë interesant dhe si duket shumë i moçëm për gjarprin, i cili u ndihmon njerëzve në nevojë. Tregimi, që është shënuar edhe jashtë kësaj treve, është ruajtur në shumë versione, por ai më interesanti është:

Marinarët (peshkatarët) kanë lundruar me një anije nëpër Liqe të Shkodrës dhe kanë gjuajtur peshk. Pa prituri, erdh furtuna dhe tallazet e hodhën anijen në shkëmb nënujor, i cili çeli vrimën në barkë. Nëpër atë vrimë, uji shpejt depërton dhe rrezikon të mbys anijen bashkë me peshkatarë (marinarë). Këtë luftë për jetë e pa gjarpri prej bregu. Ai u hodh në ujë dhe me trup të vet e mbylli vrimën dhe e shpëtoi anijen bashkë me peshkatarë. Gjarpri e ka trupin e ftohtë për arsye se uji në liqe

ka qenë shumë i ftohtë kur ai u fut në ujë për të shpëtuar peshkatarët.

Është edhe versioni, ku thuhet që vrimën në anije e bëri miu, e jo ndeshja e anijes me shkëmbin nënujor. Në një version tjetër, për të shpëtuar anijen, gjarpri u kërkoi disa kushte njerëzve në anije.

Lë të ndalemi te tregimi që rrjedh nga afërsia e Liqenit të Shkodrës. Çka është këtu aq interesante, që na shtyu ta zgjedhim për komentim tonë?

E vërtetë, ky tregim na çon larg në të kaluarën ilire. Dihet, në trevën e Liqenit të Shkodrës, në kohën para-romake dhe romake, kanë jetuar Labeatët, fis ilir. Në monedhat e tyre të farkëtuara në shekullin II para Krishtit shumë qartë shihet që anijet përpara (në ballë) dhe mbrapa kanë pasur simbolin e gjarprit. Zbukurimet që marinarët i vendosin në ballë të anijes simbolizojnë ndonjë kafshë ose shpeshherë krijesë mitologjike, për të cilën besojnë që do t'i mbrojnë në lundrimin e gjatë dhe të rrezikshëm nëpër det. Nëse Labeatët, çka është e besueshme edhe për Ilirët tjerë, vendosnin në ballë të anijes simbolin e gjarprit, e jo vetëm në anije që lundronin nëpër Liqe të Shkodrës, por edhe nëpër det, vepronin ashtu se besonin që ai do t'i mbrojnë prej fatkeqësive. Pra, gjarpri merr rolin e mbrojtësit të marinarëve, dhe kjo kurrsesi jo rastësisht.

Dihet, Ilirët e jugut e çmonin gjarprin si mbrojtës të fisit (totem), për arsye se në mitologjinë ilire gjarpri është në lidhje me vetë emrin e Ilirit. Shkrimet antike, që sjellin këto tregime, përmendin Ilirin (Illyrios), të cilin, sa lindi, e mbështolli gjarpri dhe i dha fuqinë magjike. Edhe prindërit e Ilirit, Kadmi dhe Harmonia, mbas vdekjes u shndërruan në gjarpërinj. Disa dijetar modern mendojnë që emri Ilir do të thotë gjarpër. Këtu duhet të jetë edhe shpjegimi pse gjarpri ka qenë kaq shumë popullor te Ilirët, dhe kjo në kuptimin pozitiv; ai nuk rrezikon njeriun, por e ndihmon dhe

e ruan prej të gjitha fatkeqësive. Ky besim për gjarprin në kuptimin pozitiv është i pranishëm edhe sot e kësaj dite në Ballkan, besim i përhapur për gjarprin rojë e shtëpisë; gjarpri ruan shtëpinë dhe familjen.

Tregimi që këtu paraqitem, e gati mund të përjashtohet dyshimi, është vazhdim i drejtpërdrejtë i tregimeve me të vërtetë shumë të moçme për gjarprin që ndihmon njerëzit; për arsye se në atë tregim, ai shfaqet si shpëtimtar i marinarëve, gjegjësisht peshkatarëve në Liqenin e Shkodrës, duhet të supozojmë që tregimi është i lidhur me besimin e marinarëve labeatë dhe të gjithë ilirëve për gjarprin si mbrojtësin e tyre.

Ky tregim ka rëndësi të madhe për studimin e gjurmëve ilire në besimet e tashme të shqiptarëve rreth Liqenit të Shkodrës; ai mund të na shërbejë edhe si vërtetim jo vetëm për vazhdimësinë kulturore por edhe etnike të shqiptarëve në ato troje.

*Prof. Dr Aleksandër Stipçeviqi është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kroacisë në pension. Përndryshe, është prej Arbanasit të Zadrës (Kroaci), të parët e tij rrjedhin prej Shestanit (perëndimi i Kranjës, jug-perëndimi i Liqenit të Shkodrës, rrethi i Tivarit).

Marrë prej Informator 8, Zagreb 2001:7. Zgjedhi Bajazit Duraku, Detroid, SHBA.



Simboli i gjarprit në derën hyrëse, në Tuz afër Liqenit të Shkodrës

Përkujtohet Kongresi i Manastirit

Shkruan Gjekë Gjonaj, Tiranë.

Më 17 nëntor 2008 në Pallatin e Kongreseve në Tiranë u mbajt Konferenca kombëtare njëditore me rastin e 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit, organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës në bashkëpunim me Qendrën e Studimeve Albanologjike në Tiranë dhe institucioneve të tjera shkencore e të arsimit të lartë, nën kujdesin e kryeministrit të Shqipërisë, prof. dr. Sali Berisha. Të mbledhur gjuhëtarë dhe studiues, ku nuk mungonin dhe ata kosovarë, ky takim theksoi rëndësinë e Kongresit të Manastirit. Në konferencë u theksua se ky është kongresi që përpiloi dhe miratoi alfabetin kombëtar të shqipes, alfabetin që ne përdorim sot. U vlerësua se është një nga ngjarjet më të rëndësishme për identitetin tonë kombëtar dhe për gjuhën shqipe.

Në fjalën e hapjes dhe përshëndetjes nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, akademik Teki Biçoku dhe nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, akademik Rexhep Ismajli, Kongresin e Manastirit e kanë vlerësuar si një ngjarje të rëndësishme politike, arsimore e kulturore për kombin shqiptar. Kreu i Qeverisë shqiptare prof. dr. Sali Berisha në fjalën përshëndetëse tha se Kongresi i Alfabetit të Gjuhës Shqipe është një ngjarje historike që dëshmon për orientimin perëndimor të Kombit Shqiptar.

Në seancën e paraditës, Shaban Demiraj dhe Kristaq Prifti, anëtarë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në kumtesën e përbashkët trajtuan Kongresin e alfabetit të gjuhës shqipe dhe vendin e tij në kulturën shqiptare, prof. Xhevat Lloshi (Tiranë) foli për 100 vjetorin e alfabetit të vetëm të shqipes, dr. Hysen Matoshi (Instituti Albanologjik, Prishtinë) për frymën bashkuese kulturore kombëtare të Kongresit të Manastirit, akad. Kolec

Topalli (Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë) për parimet themelore të hartimit të alfabetit të gjuhës shqipe, mr. Sala Ahmetaj (Universiteti i Prishtinës) për aspektin kombëtar të Kongresit, prof. Tomor Osmani (Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër) mbi rolin e shtypit shqiptar për njësimin e alfabetit të shqipes, prof. Mehmet



Çeliku (Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan) për strategjinë gjuhësore të njësimin të shkrimit e të gjuhës letrare shqipe, prof. Enver Hysa (Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë) për procesin e standardizimit të gjuhës shqipe, prof. Rami Memushaj (Universiteti i Tiranës) për veçoritë e fazës së parë për planifikimin gjuhësor të shqipes, kurse prof. Qemal Murati (Instituti Albanologjik, Prishtinë) referoi: "Alfabeti - shkalla e parë drejt standardizimit të gjuhës shqipe". Në seancën e pasditës, akademik Alfred Uçi (Akademia e Shkencave e Shqipërisë) referoi për alfabetin e Manastirit dhe shkollat shqipe, prof. Emil Lafa (Akademia e Shkencave e Shqipërisë) për njësimin e shkronjave dhe larminë e tingujve (çështje të shqiptimit letrar), prof. Pajazit Nushi (Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës) për temën "Alfabeti i Kongresit të Manastirit dhe perceptibiliteti i shkronjave të tij", prof. Gjovalin Shkurtaj (Universiteti i Tiranës) - "Kongresi i Manastirit si kurorëzim i vlerave fonetike e fonematike të shqipes në shkrim", prof. Remzi Pernaska (Paris) - "Kongresi i

Manastirit - kongresi i dyshshkronjëshave", prof. Imri Badallaj (Universiteti i Prishtinës) foli për variante alfabetesh tek autorët arbëreshë para Kongresit të Manastirit, dr. Muhamet Pirraku (Instituti Albanologjik, Prishtinë) për rolin e Kosovës në zgjidhjen përfundimtare të alfabetit kombëtar shqiptar, dr. Jusuf Bajraktari (Instituti i Historisë, Prishtinë) për çështjen e alfabetit sipas dokumenteve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, prof. as. Artur Lama (Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë) paraqiti "Mendime të M. Frashërit, delegat në Kongresin e Manastirit, për gjuhën shqipe dhe për kulturën shqiptare", prof. Ali Jashari (Universiteti "Fan Noli", Korçë) foli për ndihmesën e atdhetarëve korçarë për alfabetin shqip, ndërsa Hajredin Isufi (Durrës), trajtoi temën "Dom Nikollë Kaçorri në Kongresin e Manastirit", Dr. Dom Nikë Ukgjini (Shkodër) referoi: "Klerikët dhe çështja e Kongresit të Manastirit". Konferenca kombëtare kushtuar përvjetorit jubilar Kongresit të Manastirit në Tiranë përfundoi me fjalën e mbylljes se akademik Besim Bokshit (Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës).

Edhe në Bibliotekën e Ulqinit, në tubimin e organizuar prej SHAI "Art Club" dhe OJQ "Ora" më 22.11.2008, u përkujtua Kongresi i Manastirit, i mbajtur para 100 vjetëve në Manastir (Bitol, Maqedoni). Njëkohësisht, u përkujtua edhe 100-vjetori i lindjes të Eqrem Çabejit. Referuan Dr Ruzhdi Ushaku, mr Haxhi Shabani dhe Ismet Kallaba (SGJD).

Ansambli "Ulqini" e "Shtoji" në Nju-Jork

Shkruan: Gjekë Gjonaj

"Edicioni i sivjetshëm i Festivalit Artistik i Këngës dhe i Valles Shqiptare edhe kësaj herë dëshmoi se është një ngjarje madhështore kulturore mbarëkombëtare në mërgatën shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës", thotë udhëheqësi i SHKA "Shtoji", Anton Rudaj dhe shton se ky manifestim i madh kulturor i botës shqiptare u shqua për organizim të shkëlqyer, pjesëmarrje të madhe të ansambleve, këngëtarëve, valltarëve, muzikantëve dhe artistëve shqiptarë të krahinave të ndryshme.

Më 19 nëntor 2008 në "Lehman Center for the Performing Arts", në Bronks, Nju Jork, u mbajt Festivali XVIII Artistik i Këngës dhe i Valles Shqiptare në Amerikë, organizuar nga Qendra "Nëna Tereze" e Kishës Katolike "Zoja e Shkodrës" Hartsdale. Në këtë festë të madhe të kulturës dhe muzikës popullore shqiptare, e cila sivjet i është përkushtuar shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, ditës më fatlume të kombit tonë pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 1912, morën pjesë ansamble, grupe valltarësh, këngëtarësh e instrumentistësh nga Detroiti, Bostoni, Nju Jorku, Kosova, Shqipëria dhe Ulqini, të cilat interpretuan këngë e valle, pjesë instrumentale, recitime, valle e melodi të zgjedhura shqiptare nga të gjitha krahinat.



Vlerat artistike

Udhëheqësi i ansambli folklorik të Shtojit, Anton Rudaj thotë se pjesëmarrja e tyre dhe e ansambli folklorik "Ulqini" u bë e mundur në sajë të ftesës së drejtorit të përgjithshëm të festivalit, z. Mark Shkreli dhe të kryetarit të këtij festivali, dom Pjetër Popaj, si dhe të mbështetjes së kryetarit të Komunës së Ulqinit z. Gëzim Hajdinaga dhe të deputetit të Partisë Demokratike të Socialistëve, z. Luigj Shkreli. Rudaj, duke falënderuar organizatorët dhe të tjerët që e kanë mundur pjesëmarrjen në festival në Amerikë, shprehet i kënaqur me organizimin, pjesëmarrjen dhe nivelin artistik të këtij manifestimi madhor kulturor. Ai pohon se ansambli "Shtoji" u prezantua me dy valle: "Te burimi" dhe me vallen me motive nga trojet shqiptare e përcjellë me këngëtarin e mirënjohur shqiptar, Gëzim Nika, për të cilën edhe fituam çmimin special me motivacion - ansambël me perspektivë dhe shton se juria vlerësoi me çmim special edhe ansamblin "Ulqini". Sipas Rudajt, dy ansamblet nga Ulqini me dinjitet prezantuan vlerat e trashëgimisë kulturore të këtij qyteti me rrethinë.

Organizatorët

Kryetar i Festivalit ishte famullitari Dom Pjetër Popaj, drejtor i përgjithshëm, Mark K. Shkreli, drejtor organizativ, Fran Çotaj, drejtor artistik-



regjisor, Gëzim Nika, drejtor i skenës, Ludvig Çotaj, scenograf Astrit Tota, koordinator i mediave, Simon Vukël, koordinator e reklamës, Lulë Gjokaj, publiciteti dhe marketingu, Ismer Mjeku, konferensier Elza Zagreda dhe Luan Behxheti. Shoqëroi festivalin grupi muzikor "Alba" nga Nju Jorku, me kitaristin e talentuar, Edmond Xhani.

Juria

Juria përbëhej nga pesë anëtarë: Eli Gjezo, kryetare-këngëtare e njohur,

Gabriella Ivezaj



Mimoza Dajci, gazetare, Nazmi Hoxha-piktor, Lirie Ademovi dhe Nikollë Juncaj.

Çmimet

Juria unanimisht ndau këto çmime: Me çmim të parë u nderua koreografja, Axhelina Nika. Grupi i Valleve më i mirë u shpall Shoqëria Kluturore "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu," nga Kisha Shën Palit e Detroitit. Një vlerësim special u dha edhe për grupet muzikore nga Shtoji dhe Ulqini.

Çmim special u dha edhe për A-B-C-në, e kënduar nga Kori fëmijëve të diasporës udhëhequr nga Agim Kola. Çmim special juria dha edhe për këngëtarin e talentuar Albert Stanaj, ashtu si dhe për vokalistin më të mirë, John Krasniqi.

Kostumet më të bukura u vlerësuan të Shoqërisë Kulturore "Bashkimi" e grupit të valleve të Bostonit drejtuar nga koreografi Bashkim Braho.

Vlerësimet

"Sot kështu së bashku e ndjejmë veten edhe më të bashkuar në këtë sofër të madhe të këngës dhe valles shqiptare në



komunitetin tonë, nëpërmjet këtij festivali pa dallime feje apo krahine. Për mendimin tim ky festival ruan dhe përkrah traditat më të bukura muzikore dhe folklorike e autoktone shqiptare, si dhe siguron që ato të vazhdojnë të ekzistojnë dhe të kenë një lloj domethënie, edhe për brezat e ardhshëm", tha dom Anton Kqira, meshtar dhe famullitar i Kishës Katolike Shqiptare "Shën Pali" në Detroit.

karakterizuan për shpejtësinë dhe përpikmërinë e lëvizjeve nga valltarët interpretues. Nuk munguan as kostumet kombëtare që krijojnë një mozaik gjigant, as interpretimet e shkëlqyera të këngëtarëve shqiptarë, as melodia e bukur shqipe, as koreografia dinamike, as fryma e pavarësisë së shtetit më të ri në botë Kosovës, dhe as duartrokitjet e publikut. Këto dhe dukuri të tjera rrisnin vlerat artistike të këtij festivali të mrekullueshëm. Thënë shkurt, ishte kuptimplotë mbajtja e këtij manifestimi kulturor mbarëshqiptar.

"Ndjehem i kënaqur për numrin e grupeve konkurruese, për pjesëmarrjen e artistëve të rinj, sidomos fëmijëve të lindur në SHBA, për ardhjen e një numri të madh rreth 60 artistësh

nga vendlindja, të cilët sollën në skenë rite, valle e këngë nga vendlindja si dhe një mozaik kostumesh karakteristike tradicionale nga rajone të ndryshme të trojeve tona. Vërtetë ishte një manifestim i mrekullueshëm i kulturës shqiptare", tha Mark. K. Shkreli, drejtor i përgjithshëm i Festivalit.

Përfundim

Të gjitha ansamblet pjesëmarrëse shquanin në repertorin vallëzues njësi të tilla që u



Beqir Truma, veteran i folklorit

Amerikë. Kjo tregon se pavarësisht ku gjendemi, edhe përtej oqeanit, ne jemi gjithnjë bashkë si një popull, të një gjaku, të një kulture dhe të një flamuri-flamurit kuqezi. Dhe sot ndjehemi më krenar se këtë festival po ia dedikojmë pavarësisë së Kosovës", tha dom Pjetër Popaj, famullitar i Kishës "Zoja e Shkodërës" në Nju-Jork.

Festivali Shqiptar i Nju Jorkut është përpjekja e madhe e këtyre njerëzve, që të identifikojnë, dokumentojnë dhe prezantojnë artistët e folklorit nga komuniteti shqiptar në SHBA-së, dhe njëherazi të mbajë sa më të bashkuar



Suzana Ccaaj dhe Suzana Gjokaj

Një ditë në Pinç

Pinçi, katund malor, gjendet në faqen e Rumisë, në jug-perëndim të Liqenit të Shkodrës, në pjesën perëndimore të Kranjës, rrethi i Tivarit. Më 1945/1950, katundi kishte 27 shtëpi me 174 banorë. Ata merreshin me blegtori, çdo familje kishte 30-80 dhi e dele, gomar ose mushk, pula. Disa kishin nga një ka (jo lopë), katolikët kishin edhe thi. Pinçi prodhonte për nevoja të veta mjaft kollomoq (misër), grurë, thekër, groshë (fasule), kërtolë (patate), lakra, qepë dhe hudhra. Prej pemëve, këtu ka gështenja, arra, ftonj dhe pak hardhia. Shkolla fillore në Pinç një



Foto: S. Dobreci



Foto: S. Dobreci

Pjesa perëndimore e Pinçit

Palonj - pjesa lindore e Pinçit

Kisha e Shënkollit në Pinç

Kishën e rinovuan katolikët e myslimanët; më 15.11.2008, ata ishin të gjithë bashkë gjatë bekimit të kishës dhe meshës, të cilën e thanë don Fran Markiqi dhe don Nikson Shabani. Shumë prej sish kishin ardhur prej Tivarit e Ulqinit.

kohë ka qenë në gjuhën shqipe; këtu vinin edhe nxënësit prej Muriqit dhe Rjepsit.

Pinçi sot (më 15.11.2008) ka 7 shtëpi, ku jetojnë 18 vetë. Ata kanë nga 3-4 lopë (jo qe) dhe pula. Dy familje kanë nga 70-80 dele, kurse njëra 40. Tash sa kohë shkolla nuk punon, s'ka nxënës. Tash vonë u asfaltua edhe rruga deri në katund.




Foto: S. Dobreci

Banorët e Pinçit më 1945/1950

Në Palonj

1.Ramja'j Mehmet Alisë Haxhisë-Braconj	7
2.Murati Mehmet Alisë Haxhisë-Braconj	11
3.Osmani Beqos Omerit-Braconj	2
4.Brahimi Beqos Omerit-Braconj	8
5.Syloja'j Omerit Sylos-Braconj	7
6.Muja'j Isenit Brahos-Braconj	8
7.Smajli Isenit Brahos-Braconj	9
8.Qemali Isufit Mujos-Braconj	5
9.Nazimi Rexhepit Mujos-Braconj	3
10.Zekja'j Halilit Zekos-Braconj	11
11.Selimi Dashos Brahos-Braconj	7
12.Haxhia'j Ramos Zekos-Braconj	7
13.Ademi Mehmet Alisë Haxhis-Braconj	3

Në pjesën perëndimore të katundit

14.Pera'j Zefit-Çobnrelonj	7
15.Pala'j Lecit-Pâlonj	6
16.Pjetri Lucit Gjergjit-Mâlonj	4
17.Gjura'j Kols Gjergjit-Mâlonj	8
18.Stjepa'j Gjoks Nils-Gjuronj	6
19.Maci Kols Gjergjit-Mâlonj	7
20.Kola'j Tucit Gjoks-Çobnrelonj	5
21.Zefi Niks Gjonit-Markonj	4
22.Gjoni Niks Gjonit-Markonj	6
23.Gjoka'j Kols Malos-Vuçonj	9
24.Pjetri Macit Pjetrit-Vuçonj	8
25.Osmani Isenit Osmanit-Marin	5
26.Halili Isenit Osmanit-Marin	9
27.Mrika, shtja* Pals Sims-Ujkonj	2

Gjithsejt 174 banorë

*Shtja shortja, bashkëshortja

Banorët e Pinçit më 15.11.2008

Në Palonj

1.Qamili Isufit Mujos Isenit Brahos-Braconj	4
2.Smajli Asanit Isenit Brahos-Braconj	2
3.Nazmia'j Rexhepit Mujos Isenit Brahos	2
4.Ramoja'j Haxhisë Ramos Zekos	3

Në pjesën perëndimore të katundit

5.Mara (77 vjeçe), shtja* Lucit Stjeps Gjoks Nils-Gjuronj	1
6.Pashkoja'j Pjetrit Lucit Gjergjit-Mâlonj	2
7.Hajdari Istrefit Sylos Omerit-Braconj	4

Gjithsejt 18 banorë

*Shtja shortja, bashkëshortja

Tregoi **Halili Muratit Mehmet Alisë Haxhisë-Braconj**, Pinçanjor, tash në Braticë, Ulqin, më 15.11.2008.

Përgatiti Simë Gjon Dobreci



Foto: S. Dobreci

Në Pinç pamë edhe një tubë dele



Foto: S. Dobreci

Te Ubla e Lens Pinçanjore. Halili dhe Haxhia i Muratit - Braconj, thanë: "Ubla e Lens e ka ma t'mirin ujë". Banorët e marrin ujin prej ublave.

Kjo ditë, më 15.11.2008, ishte ditë feste për Pinçin; mbas meshës, në Gurina u organizua gazmendi dhe kokteji, ku u soll edhe Vallja e Shestanit.



Foto: S. Dobreci

Kleri katolik dhe Kongresi i Manastirit

Shkruan Dr. dom Nikë Ukgjini*

Në prag të Kongresit të Manastirit, meqenëse ende përballej me pushtetin Turk, në aspektin shpirtëror dhe kulturor, kombi shqiptar kishte vendosur lidhje më të dendura me idetë dhe kulturën përparimtare të popujve Perëndimorë. Përhapja e kulturës dhe e arsimit kombëtar në këto momente do të ndihmonte në emancipimin e popullit nga fanatizmi, prapambetja, intoleranca e nga dasitë fetare të mbjella nga sundimtarët osmanë.

Duke e kuptuar këtë nevojë historike, Kisha katolike në Shqipëri vazhdoi të punojë me një intensitet edhe më të madh për ngritjen dhe zhvillimin e arsimit fetar e kombëtar për përhapjen e tij në popull, për lëvrimin e gjuhës e të kulturës shqiptare në përgjithësi.

Shkodra, qytet në Veri të Shqipërisë e cila mbante me të drejtë epitetin *djepi i kulturës dhe i arsimit*, për shkak të një historie e kulture të lashtë zhvillimi, në aspektin kishtar, si

Kryedioqezë në metropolin shqiptar, luante në të gjitha fushat rolin e një orkestruesi ndërmjet (Krye) dioqezave shqiptare dhe bashkësisë ndërkombëtare. Në saje të pozicionit që kishte, Shkodra si Kryedioqezë metropolitane, ndërhynte vazhdimisht tek Propaganda Fide në Romë si dhe tek qeveria Austro-hungareze për ta shtuar kujdesin e tyre financiar dhe organizativ, për shkollat shqipe në trevat shqiptare dhe për botime të ndryshme. Rreth këtyre çështjeve na flasin dokumentet e pabotuara të Arqipeshkvisë së Shkodrës të cilat ruhen në Arkivin Qendror të Shtetit. Në lidhje më çështjen në fjalë, veçojmë korrespondencën ndërmjet Arqipeshkvit të Shkodrës Imzot Pashk Guerrinit dhe Propaganda Fides, mbi problemet e botimeve të librave shqip si dhe

probleme të shpërndarjes në popull (dosja 40, 1889 dosja; 36, 1898). Tek fondi në fjalë (132) në dosjen 17, viti 1894, gjejmë korrespondencën ndërmjet Imzot Guerrinit me Kolegjin Papnor në Shkodër dhe Propaganda Fide, ku bëhet fjalë rreth shkollave shqipe edhe në Prizren. Në dosjet e Arqipeshkvisë gjejmë edhe fakte të tjera që na flasin për korrespondencën e vazhdueshme të Imzot Guerrinit me qeverinë Austro-hungareze rreth shkollave dhe botimeve shqip (1892, 1898).

Përhapja e shkollave të mësimin në gjuhën shqipe si dhe botimi i vazhdueshëm i librave në shqip,

akademie (instituti) për studimin e dialekteve, vendosjen e gjuhës së përbashkët, hartimin e gramatikës dhe të fjalorit të gjuhës shqipe. Kjo ide e nxitur edhe nga situata e krijuar në terren, u bë temë diskutimi ndërmjet (krye)ipeshkvijve e të gjitha dioqezave (Shkupit, Durrësit, Shkodrës, Lezhës, Pultit, Sapës dhe abacisë së Mirëditës) nga 1-6 Maj 1902; më vonë edhe nga Propaganda Fide në Romë dhe Konsullata Austro-hungareze në Shkodër. Kjo e fundit kishte dedikuar edhe 400 franga për formimin kësaj akademie (instituti) dërguar Arqipeshkvisë së Shkodrës, për çka na



flasin dosjet nga f o n d i i Arqipeshkvisë së Shkodrës (1901 1902). Nga letra e Imzot Guerrinit (1902), mësohet se kjo ide fisnike kishte mbetur e porealizuar për arsye të mosarritjes së konsensusit ndërmjet ipeshkvijve, kërkesë kjo e qeverisë austro-hungareze dhe e Propaganda Fides.

Edhe pse të tre alfabetet i jepnin ton të gjitha veprimtarive kul-

shtruan tek klerikët intelektualë nevojën e përcaktimit të alfabetit, temë kjo e debatuar sidomos nga gjysma e dytë e shek. XIX e në vazhdim. Kryedioqeza e Shkodrës, për shkak të pozicionit që kishte, u gjet përsëri në rolin e koordinuesit, ndërmjet inteligjencës shqiptare dhe bashkësisë ndërkombëtare për bisedime që po zhvilloheshin rreth çështjes së një alfabeti shqip.

Meqenëse librat shkollorë dhe revistat në veri të Shqipërisë, me qendër në Shkodër, botoheshin në tre alfabete: në alfabetin e vjetër (Jezuitë), të Shoqërisë Bashkimi (1899) të abat Pregë Doçit dhe Agimi (1901) të Dom Andre Mjedës, u ndie i nevojshëm përshtetimi për një unifikim sa më parë të alfabetit. Me këtë rast disa klerikë intelektualë të përkrahur e Imzot Guerrini, kishin hedhur idenë për krijimin e një

turore dhe arsimore, jo vetëm në Shkodër, por edhe më gjerë, sipas korrespondencës së lartpërmendur del shumë qartë se në përzgjedhjen e alfabeteve nga ana e hierarkisë kishtare, më tepër krahmbajtje kishte alfabeti i Ndre Mjedës, duke qenë se vëllai i tij Imzot Lazër Mjeda, kishte influencë si ipeshkëv në hierarkinë e lartë kishtare në Shqipëri e në Romë. Nga ana tjetër dom Ndreu, si gjuhëtar, gëzonte edhe simpatinë e qeverisë Austro-hungareze (1903, 1904).

Nga aktivistët e tjerë të cilët vepruan për çështjen e gjuhës e të kulturës shqiptare duhen veçuar pjesëmarrësit e parë të mbledhjes së Shkrelit, intelektualit e atdhetari i të gjitha kohërave, abat Pregë Doçi, organizatori i këtij takimi Dom Ndoc Nikaj e pjesëmarrësit dom Mark Shllaku, dom



Zef Shkreli, dom Jak Serreçi e dom Dodë Koleci. Në vitin 1893 në Shkrel të Malësisë së Madhe, ata krijuan në mënyrë të fshehur lidhjen kombëtare të quajtur "Bashkimi Shqypar", që, siç thotë dëshmitari i mbledhjes dom Ndoc Nikaj, "kishte për detyrë Bashkimin e Shqyptarve pa dallim feje dhe fisi". Nga kjo mbledhje e pati zanafillën e vet edhe formimi i shoqërisë "Bashkimi" në vitin 1899 me kryetar abat Doçin. Ndër kontribuesit e vyer duhen përmendur edhe anëtarët e Kuvendit themelues të Shoqërisë "Bashkimi" Imzot Lazër Mjeda, Imzot Jak Serreçi, dom Dodë Koleci, dom Gjergj Koleci, dom Mëhill Bushati-Çuni, dom Nikollë Sheldia, etërit françeskanë Gjergj Fishta e Pashko Bardhi, dom Ndoc Nikaj, jezuitët pjesëmarrës, si dhe laikët Mati Logoreci me shokë etj.. Ndërsa vlerësime të posaçme u duhen bërë botuesve të fjalorit Fialuer i Rii i Shcypes (Shkodër, 9 janar 1908, abat Doçi si udhëheqës i projektit, hartuesi dom Dodë Koleci e ndihmësit e tij, dom Ndoc Nikaj dhe dom Mark Shllaku). Fjalori ishte një udhërrëfyes i mirë për ngjarjen e ndodhur në Kongresin e Manastirit. Në vazhden e aktorëve që kontribuan për unifikimin e alfabetit përmendim edhe Atë Shtjefën Gjeçovin dhe letërkëmbimin e tij me konsullin austro-hungarez (1901) dhe Atë Vinçenc Prenushin e korrespondencën e tij rreth punës së Kongresit, me Drenovën, Nolin, Luarasin (14 shkurt dhe 27 korrik 1908) Kurora e të gjitha këtyre përpjekjeve, të themi gandise, ishte ngjarja e ndodhur më 14-22 nëntor 1908, kur me pëlqimin e të gjithë anëtarëve të komisionit u vendos që populli shqiptar, pas shumë shekujve, të kishte alfabetin e vet unik.

Edhe në këtë ngjarje historike për

kombin, klerikët katolikë dhanë kontributin e tyre të çmuar.

Përmendim këtu: Atë Gjergj Fish-tën, kryetar komisioni dhe përfaqësues i shoqërisë "Bashkimi", dom Ndre Mjedën përfaqësues i shoqërisë

"Agimi" dhe dom Nikollë Kaçorin, delegat i Kryedioqezës së Durrësit, më vonë nënkryetar i qeverisë së Vlorës. Duke u nisur nga vlera e madhe që kishte kjo ngjarje për kombin, Kongresi i Manastirit gëzoi përkrahje të madhe edhe nga faktorë të tjerë kishtarë. Në fillim të punimeve, Hil Mosi, i cili ishte në rolin e sekretarit, lexoi një letër urimi për mirëvajtjen e Kongresit, dërguar nga Preng Doçi, abat i Mirditës dhe kryetar i shoqërisë "Bashkimi", letrën e Preng Bibë Dodës, dhe letrën e Domenik Pasit (1908) të dërguar nga rektori i Seminarit Papnor të Jezuitëve të Shkodrës. Sipas dokumentacionit të Kryedioqezës së Shkodrës, kemi një letër urimi dërguar Kongresit edhe nga Imzot Pashk Guerrini së bashku me 30 intelektualë shkodranë (9 nëntor 1908). Ndër të tjera në këtë letër thuhet: "Gnjiesia e abees asct ner maa scejte cestie per gith nee."

Që vendimet e Kongresit të Manastirit kanë qenë të mirëpritura edhe tek faktorët e tjerë të rëndësishëm, dëshmon korrespondenca e mëvonshme

ndërmjet Arqipeshkvit të Shkodrës, Imzot Guerrinit, atij të Durrësit, Imzot Preng Bianchut mbajtur me Propaganda Fide në Romë dhe konsullatës austro-hungareze, ku ndër të tjera thuhet se botimi i librave shqiptari e tutje do bëhej sipas vendimit të Kongresit të Manastirit. (1909). Në vazhden e saj është dhe letra e rektorit të Seminarit Jesuit, Liugi Cattaneo, 1909, drejtuar të gjithë ipeshkvijve për botimin e katekizmit të Papa Piut X në gjuhën shqipe sipas Manastirit.

Në përfundim themi se, edhe pas Kongresit të Manastirit, klerikët katolikë nuk kanë reshtur asnjëherë se punuari në rimëkëmbjen e mëtejshme të gjuhës, kulturës e traditës shqiptare, pjesë e pandashme e përkushtim të tyre ungjillor. Duke përhapur në popull arsimin dhe përgjithësisht kulturën në gjuhën shqipe, ata synonin të shpejtonin zgjimin e tij kombëtar, të ndihmonin në ngritjen e mëtejshme të ndërgjegjes politike e të arrinin aftësimin e shqiptarëve për një jetë shtetërore të pavarur.

Pas gjithë kësaj që thashë më lart, do të doja ta mbyllja referatin tim me citimin e fjalëve të romancierit të parë shqiptar dom Ndoc Nikaj, i cili për rëndësinë e fjalës së shkruar, në kujtimet e tij thekson: "Shkrimi e leximi asht porsiziam i mbuluem qi ndezet per kadal në terr, e me ma të paren rasë qi një guximtar i largon hinin, shperthen në flakë. Turkija prandej me shume arsye, dronte kulturen e shkrimet e kendimet se sa për giuhen e folun gojarisht nuk u interesue".

*Pjesë e kumtesës për 100-vjetorin e Kongresit të Manastirit e mbajtur në Konferencën kombëtare në Tiranë më 17 nëntor 2008.

Aforizma

Vullneti pa taktikë është si qerrja me rrotë të thyera.

Dielli është më i madh se retë, por ato shpeshherë i ndalin rrezet e tij.

Punëtori i mirë ka kryepunëtor ndërgjegjen e vet.

Nëse turpërohesh para ndërgjegjes sate, kurrë nuk do të merret fytyra para botës. Shpeshherë drejtësisë i duhet forca, si dorës së djathtë e majta.

Vajza e gruas vejë është tri herë jetime, nëse e ëma nuk është e ndershme.

Veprat e mira letrare e hedhin mendjen e njeriut prej ferrit në parajsë.

Viktimë më e madhe në botë është gruaja e mirë e martuar për burrë të keq.

Fati është më i fortë se çeliku, por mençuria është më e fuqishme se fati.

Jeta pa vepra është si gjumi pa ëndrra.

Mashkulli mund të jetë fatlum me çdo femër deri sa nuk e dashuron.

Dyshimi është mjegull, i cili shpeshherë i mbulon pamjet e bukura.

Gjëja e fundit të cilën e humb njeriu është shpresa.

Shaban Hasangjekaj, Martinaj, Guci

Salçi dikur dhe sot

Salçi, katund 8-9 km larg Ulqinit, shtrihet në faqen jugore të malit Mazhur, ndërmjet Krythës dhe Kullomzës. Klima është aty shumë e shëndetshme. Prej Bardhonjsh e deri në Sojmirë ka 13 burime (kronje). Më 1965, katundi kishte 42 familje me 230 banorë. Ata merreshin kryesisht me blegtori dhe pemëtari. Mbanin lopë (gjedhë), dhi, dele, pula, thi, gomarë dhe dikush kuaj. Salçi është i përshtatshëm për ullinj, fiq, hardhia, qershia, vishnja, pjeshka, dardha, molla, bajame, ftonj, shega, arra, grurë, qepë, hudhra. Asfaltimi i rrugës deri te Kisha e Salçit (mjedisi i katundit) u krye me 2003.

Salçi sot (më 12.11.2008) ka vetëm një shtëpi me 4 vetë, që aty banojnë dimër-verë.

Shënimet **Kola'j Luks Macit Luk'Pâlit Peconj**, më 12.11.2008.
Përgatiti **Simë Gjon Dobreci**

Salçi - banorët më 1965

Bardhonjt e Salçit

1.Luka'j Zefi Macit Bardhonj	3
2.Marku'j Pjetrit Gjurës Bardhonj	6
3.Pala'j Pjetrit Gjurës Bardhonj	7
4.Kola'j Pjetrit Gjurës Bardhonj	4
5.Jaku'j Gjergjit Leks Bardhonj	7
6.Kola'j Preçit Leks Bardhonj	4
7.Kola'j Mashanit (Macit) Pjetër Mar'Gjoks Bardhonj	5
8.Gjergji Gjoks Pjetër Mar'Gjoks Bardhonj	4
9.Rroku'j Bardhonj (Pjetër Simonit)	4
10.Nika'j Pjetër Kocit Nilonj	3
11.Marku'j Preçit Niks Mar'Luks Bardhonj	3
12.Zefi Gjonit Niks Mar'Luks Bardhonj	5
13.Kola'j Gjoks Mar'Gjoks Martinonj	7
14.Pera'j Gjurs Pers Bardhonj	7

Pjesa tjetër e Salçit

15.Luka'j Pals Niks Jankonj	5
16.Kola'j Pals Niks Jankonj	7
17.Kola'j Luks Macit Luk'Pâlit-Peconj	9
18.Stjepa'j Preçit Jankonj	9
19.Preçi Stjeps Preçit Jankonj	4
20.Jaku'j Pjetrit Pers Bibs Jankonj	3
21.Gjergji Pjetrit Pers Bibs Jankonj	4
22.Pala'j Niks Pjetër Pâlit Junkonj	4
23.Zefi Luks Markut Pâlit Junkonj	4
24.Leka'j Luks Markut Pâlit Junkonj	6
25.Gjergji Pals Kols Pâlit Pepiqi	6
26.Gjoka'j Markut Preç(ulit)-Lukiqi	3
27.Gjergji Leks Gjoks Pals-Dedonj	5
28.Kola'j Pjetër Kols Mar'Lens Dobreci	6
29.Çeka'j Monit Gjeçit Briskonj	6
30.Zefi Çeks Monit Gjeçit Briskonj	3
31.Nika'j Lecit Koloviq	8
32.Preçi Kols Preçit Kols Koloviq	13
33.Pjetri Niks Markut Per'Gjoks Dedonj	5
34.Nika'j Luks Markut Luk'Markaj Lukiqi	8
35.Pala'j Zefit Markut Luk'Markaj Lukiqi	11
36.Kola'j Zefit Palucit Preç Pâlit Lukiqi	3
37.Kola'j Leks Preçit Markut Preçit Lukiqi	9
38.Pjetri Leks Markut Preçit Lukiqi	6
39.Mara (?), shtja* Gjonit Gjergjit Palucit-Lukiqi	5
40.Prena (ose Mrika) Palucit	1
41.Marku'j Luks Markut Preçit Lukiqi	3
42.Maria, shtja* Macit Gjoks Gjeks Stjeps-Dedonj & Anri Luviqi-Lulaj	4

Gjitjsej banorë 230

*Shtja - shortja, bashkëshortja



Foto: Bësnik Dobreci

Kroni i Salçit. Këtu del uji që shkon për Ulqin



Foto: S. Dobreci

Ceremoni fetare rreth kishës së Salçit për Shpjetër, më 19.6.1956



Foto: S. Dobreci

Kisha e Salçit u ndërtua më 1850, u restaurua më 1885, e rrënoi termeti më 1979.

Salçi, më 12.11.2008

Lezja, shtja* Markut Preçit Niks Mar'Luks-Bardhonj & Nika'j Pjetrit Macit Niks Marluks-Martinaj - 4 vetë

Në Salç qëndrojnë kohë mbas kohe:

- 1.Gjergji Gjoks Pjetër Mar'Gjoks Bardhonj
- 2.Leka'j Gjergjit Leks Gjoks Pals-Dedaj
- 3.Anti Niks Pjetrit Niks Markut Pergjoks-Dedonj

*Shtja - shortja, bashkëshortja

Shasi - qytetërim i moçëm

Shkruan Gjekë Gjonaj

"Unë Shasin e gjykoj si një qendër mesjetare shumë atraktive në pikëpamje shkencore dhe mund të them se potencialisht është e mundur që të bëhen kërkime sistematike në këtë vend. Se çfarë rezultatesh do të japin kërkimet, besoj se është herët të flitet, por nuk mohoj se mund të ketë edhe të papritura që në arkeologji janë normale", thotë prof. ass dr. Gëzim Hoxha.

Falë angazhimit të organizatës joqeveritare "Ora", më 19 nëntor 2008, një grup i arkeologëve nga Shqipëria vizitoi Qytetin e Vjetër të Shasit. Grupin e përbënin prof. Dr. Ardian Marashi, drejtor i Qendrës së Studimeve Albanologjike Tiranë, prof. Dr. Shpresa Gjongecaj, drejtoreshë e Institutit të Arkeologjisë, prof. ass Dr. Gëzim Hoxha, prof. ass Dr. Luan Përzhita, prof. Dr. Faik Drini, prof. Dr. Skender Muçaj, prof. ass Dr. Adem Bunguri dhe mr. Elio Hobdari. Disa prej tyre për herë të parë vizituan Shasin. Qëllimi i vizitës ishte njohja me



Foto: S. Dobreci

Rrënojat e Shasit

vlerat arkeologjike të këtij lokaliteti si dhe mundësia e realizimit të ndonjë projekti të përbashkët të gërmimeve arkeologjike të arkeologëve shqiptarë së bashku me ato malazezë dhe të huaj; ky edhe ishte propozim i përfundimit të sesionit shkencor "Shasi i lashtë, monument i kulturës", që u mbajt në muajin maj 2008 në Ulqin në organizim të shoqatës "Ora".

Arkeologu as dr. Gëzim Hoxha thotë se ndjehet i befasuar nga kjo vizitë, nga natyra e bukur e Shasit, nga liqeni, nga ndërtimi i këtij qyteti i cili ka humbur jetën e vet. "Mendoj se Shasi me atë strukturën e bukur të kishave, me ato mure dhe me kombinacionin me natyrën, na jep mesazhe të bukura të një civilizimi të kaluar i cili ka prodhuar kulturë dhe në mënyrë të veçantë monedha. Të gjitha këto ne na japin një entuziazëm për të plotësuar më mirë tablonë e historisë dhe arkeologjisë të këtij rajoni të lashtë mesjetar", thotë Hoxha. Ai pohon se mesazhi i civilizimit të Shasit është i njëjtë si i qytetërimeve të Shurdhanit, Drishtit, Kalasë së Shkodrës dhe të Balezës, pastaj Kalasë së Shpuzës (Mali i Zi), ku u krijuan komunitete njerëzish që

kanë ditur të jetojnë bashkë, që kanë ditur të ndërtojnë marrëdhënie njëri me tjetrin. Pra, mesazhi kryesor është: bashkëpunimi sjell përparimin", thotë Hoxha.

Edhe prof. ass. Dr. Luan Përzhita pajtohet me kolegun e tij se Shasi është një qendër e rëndësishme mesjetare me vlera të padiskutueshme arkeologjike ende të panjohura. "Rrënojat e kishave të Shasit tregojnë madhështinë e tyre. Kjo popullatë e cila ishte vendosur atje në atë kohë tregon se kishte krijuar jetën e saj në nivel të civilizimit të barabartë me të gjithë zhvillimet e tjera që ndodheshin ose zhvilloheshin në atë kohë. Për çdo studiues, Shasi paraqet një interes mjaft të veçantë dhe të josh me atë bukurinë e vet. Kjo është një bukuri natyrore, por edhe me rëndësi historike; ne sot shohim diçka të mbuluar me mister; ka nevojë të hulumtohen, të studiohen dhe të sqarohen të gjitha ato legjenda e ato histori të fshehta që ngërthen në vete ky vendbanim i lashtë historik", thotë Përzhita. Edhe arkeologët e tjerë që vizituan Shasin janë të mendimit se ka ardhur koha që ky vendbanim historik duhet t'i nënshtrohet një kërkimi arkeologjik. Ata shprehin gatishmërinë dhe vullnetin e tyre që bashkë me homologët malazez të provojnë të zbardhin dhe të hedhin dritë mbi këtë tokë të zbrazur, mbi këto objekte dhe monumente të kulturës sonë.

Me këtë rast, arkeologët nga Shqipëria vizituan edhe Muzeun e Ulqinit.



Foto: Fismik Dobreci

Rrënojat e kishës së Shmrisë në Shas

Emigrimi shkretoi Amullin

Shkruan Gjakë Shkreli

Rilindësit tanë kanë shkruar shumë emigrimin, këtë plagë shekullore të popullit tonë e cila si kolera shkretoi vise të tëra ku me shekuj jetojnë shqiptarët si popull autokton, kolerë e zezë e cila fatkeqësisht as sot nuk po i ndahet këtij populli shumë të vuajtur. Emigrimi te shqiptarët në Malin e Zi, i cili filloi në vitet '60-të të shekullit të kaluar për fat të keq është i theksuar edhe sot. Më kujtohen ato vite kur filluan ikjet e disa individëve bashkë me familjarët e tyre, kinse në fshehtësi, madje me thasë të mbushur me plaçka, sheka me djathë e artikuj të tjerë, të cilët me pasaporta të rregullta kalonin kufirin jugosllavo-italian, dhe vendoseshin në kampe në Itali, prej nga mbas një kohe të caktuar vazhduan rrugëtimin për në Shtete të Bashkuara të Amerikës si emigrant politik-ekonomik. Duke përkujtuar ditët e atëhershme kur vëll-ezërit tanë, kushërinjtë, komshitë (fqinjët) lëshonin shtëpitë e shkrettonin vendin në kërkim të një jete më të lumtur me më shumë liri e pasuri ekonomike nuk mund të mos theksoj edhe pasojat dhe plagët që la mbas emigrimi masiv i viteve 60-të. Kësaj plaje të rëndë të shqiptarëve nuk i shpëtuan as dy fshatrat e mia Amulli Naltë dhe Amulli Poshtë, të cilat vështirë se do të shërohen ndonjëherë nga kjo kolerë e quajtur emigrim. Amulli Poshtë, ku dikur jetonin 28 familje (secila nga ato kishte mesatarisht 6 anëtarë), tërësisht u shkretua. Sot ky vendbanim është i pa banuar. Duke kaluar nëpër Amull Poshtë, sidomos ne që jetuam një kohë së bashku, është e vështirë të mos kaplojë një ndjenjë e rëndë. Emocionet është vështirë t'i përmbash. Nuk mund të mos kujtosh zërat e fëmijëve që atëherë këndonin e brohorisnin gëzueshëm duke ruajtur bagëtinë. Nuk mund të mos kujtosh gjëmimin e rrotave të qerreve që rënkonin nën barrën e rëndë. Është e pamundur të mos kujtosh tingujt e lahutës dhe zërin e

lahutarit, duke menduar se je në Lugjet e Verdha, sepse lahutari këndonte për Mujin dhe Halilin. Nuk mundesh kurrësi e të mos bien ndërmend thirrjet e njëri tjetrit për t'u marrë vesh se ku do e kalonin kohën e lirë, sidomos mbasdarkat e gjata të dimrit, ose kënga e Franit të shoqëruar prej tjerëve, veçmas prej Vaselit edhe pse ishte më i vogël. Nuk mund e të mos kujtosh ndjelljen e deleve, hallakatjen e shumë të tjera, që këtij fshati të vogël i jepnin gjallëri. Kështu ishte dikur. E sot? Amulli Poshtë ka rënë në qetësi të pafund. Askund zë njeriu. Shtëpitë tani janë rrënuar. Rrugët janë nxënë nga degët. Nga kjo pamje kupton se këtu tani mungon dora e njeriut, mungojnë duart e vjera të atyre që dikur aq bukur

Kur njeriu kalon nëpër këto dy fshatra s'ka si e të mos t'i bien në sy pasojat e emigrimit si në numrin e banorëve ashtu edhe në gjendjen sociale e shpirtërore. E njëjta gjë ndodhë edhe me Amullin Naltë nga i cili u larguan për të njëjtat shkaqe këta familjarë: Zef Nika, Nikollë Preka, Gjakë Kola, Zef Kola, Luigj Kola, Lekë Nika, Gjergj Vuksani, Nosh Frani, Mirash Luca, Nua Luca, Palush Luca, Mark Gjetoja, Fran Gjetoja, Rrok Zefi, Lanush Sadiku, Rexhep Sadiku, Brahim Sadiku, Binak Sadiku, Smajl Cafiq, Kadri Muhja, Gjon Zefi, Nikë Marashi, Vat Marashi, Pjetër Marashi, Rrok Marashi, Pashko Nika, Gjakë Nika, Zef Nika, Fran Zef Prela, Zef Prelushi, Nosh Prelushi, Rrok Nikolla, Nikollë e Viktor Preka, Nikollë



Një pamje e Amullit

Rroku, Martin Kolë Lleshi, Luigj Lleshi, Fran Deda, Tomë Deda, Lukë Deda, Fran Marku, Nikollë Marku, Luigj Marku, Lekë Marku dhe Kolë Noci. Edhe në Amullin Naltë sheh shumë shtëpi të rrënuara e shumë toka të lëna djerr. Shpeshherë mendoj dhe mendohem të gjej shkaqet e lëshimit të trojeve të të parëve, të kësaj ikjeje masive të njerëzve, madje edhe të atyre në moshë të thyer. Në analizën time më

e punuan këtë tokë dhe ndërtuan këto shtëpi. Disa nga ata njerëz tani jetojnë e gjallërojnë larg vendlindjes në Amerikë, kurse një pjesë e tyre edhe ndërruan jetë. Banorët e këtij fshati tashmë të braktisur nderuan varrezat e fshatit, ku sollën kufomat e të dashurve të tyre dhe i varrosën këtu, sepse ishte amaneti dhe dëshira e tyre që të pushojnë në amshim në dheun e tokës mëmë, për çka u jemi shumë mirënjohës. Edhe varrezat në mungesën e të gjallëve janë lidhje e fortë me truallin e të parëve. Do të ishte e udhës që Vaseli me lahutën e tij ta këndonte një këngë, meqë vetëm lahuta mund ta përshkruajë një gjendje të tillë. Vetëm lahuta ndër shekuj besnikërisht i pasqyroi vuajtjet dhe hallet e këtij populli që vuan edhe sot e kësaj ditë. Titulli i këngës duhet të jetë "Na fal Amull që të shkretuam" ose "Mos na nemni trojet tona"- mendoj unë.

rezultojnë se shkak i kësaj është më i thellë dhe më i komplikuar se sa janë arsyet ekonomike e sociale. Gjithmonë pyes vetveten: A thua vallë gjithë këta njerëz kanë qenë të rrezikuar për kafshatën e gojës? A do të kishte mundur çereku i tyre të jetojë në trojet e veta? A thua vallë me shkuarjen e tyre në Amerikë i shpëtuan vdekjes? A e dinë edhe ata se ky vend ka nevojë për dasma, për fëmijë, djem e vajza, për nuse, por edhe për morte (vorrime, varrime)? Sepse edhe kjo e fundit është pjesë e pandarë e jetës. E kështu pyetje e konstatime pafund. Dhe si përfundim. Në Amullin Naltë dhe në Amullin Poshtë sot syri të sheh shtëpitë e lëna pas dore në mëshirën e kohës dhe tokat djerrinë. Ndërkaq neve që i kemi mbetur besnik fshatit jetojmë me shpresë se një ditë të bukur vëllezërit tanë mërgimtarë do të kthehen dhe do ta gëzojnë truallin e të parëve.

Reçasit e duan vendin e vet

Shkruan: Gjekë Gjonaj

Vitet 70-të të shekullit të kaluar për shqiptarët në Malin e Zi janë vite të shpërnguljes. Kjo plagë e rëndë e shqiptarëve me shekuj nuk i ka shkapërcyer as banorët e Reçit, të Komunës së Ulqinit. Të pakënaqur me kushtet e vështira të jetesës dhe me shumëçka tjetër, shumë familjarë të këtij fshati vendosën të marrin rrugën e mërgimit, pa ditur se çfarë i prët atje, në tokë të huaj. U nisën me lot në sy dhe pas shumë peripecish arritën në tokën e premtuar, siç e quajnë Amerikën. Shtëpitë e vjetra prej guri të reçasve mbetën të zbrazëta. Shkuan atje larg përtej oqeanit për kafshatën e gojës, për një mirëqenie më të mirë familjare, për një trajtim më të mirë njerëzor, për një jetë më të denjë njerëzore, që për shqiptarët e asaj kohe ishte ëndërr. U larguan nga njerëzit e tyre më të dashur, nga nëna, babai, vëllai e motra, duke i



Mërgimtarët e Reçit ndihmuar ndërtimin e kishës së Shën Kollit në Reç

ndarë zemrat përgjysmë, duke u përgjysmuar familjet dhe duke i boshatisur shtëpitë. E çfarë morën nga vendi ku u lindën, ku u rritën? Morën me vete kujtimet e ëmbla të jetës familjare pa hile dhe engjëllore, ëndrrat e bukura nga vendlindja dhe dëshirën e madhe për një të ardhme më të mirë dhe më të drejtë, si individuale ashtu edhe kolektive. Edhe pse larg vendlindjes, mërgimtarët reças në Amerikë kurrë nuk i

harruan idealet kombëtare, traditat dhe zakonet shqiptare. Vlerat njerëzore dhe kombëtare, si dhe dashuria me gjithë shpirt e zemër për vendlindjen, tokën stërgjyshore, ishin dhe mbetën udhërrëfim dhe ideal madhor jo vetëm për brezin e tyre, por edhe për gjeneratat e ardhshme. Dëshmi për këtë janë edhe investimet e shumta me vlerë miliona dollarësh të cilat sot për fat të mirë e hijeshojnë këtë vendbanim me popullatë shqiptare. Urojmë nga zemra që këto shtëpi luksoze të mbushen me reças të kthyer në katundin e vet, në vendin e vet, në vendin e të parëve vet.



Shtëpia e Ejll Preç Gjin-Zagredës



Shtëpia e Antos, Pashkos dhe Palë Gazivodës



Shtëpitë e Shaban



dhe Salë Sefaj

VËSHTRIM

Libri "Shkolla shqipe në Krajë" i autorit Muharrem Hardolli, i botuar në Nju-Jork, në janar më 2008. Redaktor i librit është Ismail Ahmeti, ndërsa recensent janë Idriz Lamaj dhe Rexhep Dedushaj. Ky është libri i dytë i këtij lloji, pas atij të Hajrullah Koliqit "Historiku i arsimit në Krajë", botuar më 1999.

Në librin "Shkolla shqipe në Krajë" autori Muharrem Hardolli përshkruan rrugën e mundimshme dhe tejet të vështirë e me shumë pengesa të natyrave të ndryshme të shkollës shqipe në këtë trevë iliro-shqiptare.

Autori me hollësi përshkruan etapat kryesore të zhvillimit të shkollës dhe arsimit në përgjithësi ndër shekuj në Krajë.

Për ta bërë këtë pasqyrim sa më të qartë për lexuesin, Hardolli ka paraqitur dokumente të shumtë me vlerë, fakte historike konkrete, argumente tjera si dhe dëshmi gojore.

Një vend të posaçëm dhe mjaftë t theksuar zë figura e mësuesit, atij pishtari që i dha dritën dhe shkëlqimin e artë dhe të duhur shkollës shqipe dhe arsimit në përgjithësi në Krajë. Edhe përkundër vështirësive të mëdha, sakrificës dhe peripeçive, këta mësues u bënë kurorë të kulturës kombëtare dhe lëvruesit e kultivuesit e parë të gjuhës dhe arsimit shqip në këtë truall, shkruan autori në këtë libër.

Autori librin e ndanë në kapituj të shumtë. Tek lexuesi padyshim interesim paraqesin kapitujt siç janë: Fillet e arsimit në Krajë, Shkolla dhe arsimit në Krajë në periudhën 1878-1945, Shkolla dhe arsimit në Krajë pas luftës së dytë botërore e kështu me radhë.

Një vëmendje të veçantë autori ia kushton në këtë libër plan-programeve dhe planeve mësimore gjatë rrjedhave të viteve.

Hasen në libër edhe tabela dhe grafikone të llojeve të ndryshme në të cilat pasqyrohet numri i nxënësve ndër vite, ku autori bën e dhe komente lidhur me rënien rapide të nxënësve nga viti në vit, gjithmonë kjo sipas hulumtimeve të autorit.


Një vend të rëndësishëm në libër përfshijnë edhe fotografitë e objekteve të dikurshme shkollë që padyshim paraqesin dëshmi okulare dhe tejet të rëndësishme për rrjedhat e arsimit në Krajë. Po ashtu këtu hasen edhe fotografitë e objekteve ekzistuese të sotme shkollë në gjithë trevën e Krajës duke nisur nga shkolla qendrore-shkolla amë në Ostros si dhe objektet e paraleleve të shpërndara të kësaj shkolle nëpër fshatrat e Krajës.

Libri "Shkolla shqipe në Krajë" është një përpjekje që të sqarohen dhe të zbardhën dilema të mëdha rreth rrjedhave të arsimit në Krajë.

Libri s'ka dyshim paraqet një pasqyrë më reale për shumë lexues që pak i kanë të njohura rrjedhat shoqërore, e në këtë drejtim edhe historikun e arsimit në gjuhën shqipe në këtë trevë.

Qëllimi i këtij vështrimi nuk ka të bëjë aspak me vlerësimin kritik të librit. Këtë në radhë të parë do ta bëjë lexuesi si dhe ata të cilët drejtpërdrejt merren me trajtime dhe vlerësime kritike të temave dhe përmbajtjeve të tilla.

Shkruan Ali Gjeçbritaj



Kranjanët thonë

Ai isht i zoti punës.
 Ai ban çka do vet.
 Ai nuk trembet prej askuj.
 Ai nuk e ruen vedin.
 Ai isht xhymert i madh.
 Ai isht i mirë si buka.
 Ai nuk të le ne rrugë.
 Ai kqyr punën e tij.
 Ai nuk isht qederi kuj.
 Ai i del detit kamë.
 Ai isht gjellë e pa krypë.
 Ai s'ka tahmin hiç.
 Ai s'di me lidh paturet.
 Ai gja mas shpirtit s'ka
 Ai isht i mërdhitun.
 Ai isht me ruejt delet.
 Ai ban petulla me ujë.
 Ai nuk t'nep ujë me pi.
 Ai ska gja mas shpirtit.
 Ai shkon si zotni i veshun.
 Ai ban kokrren e qefit.
 Ai e ka dyrnjan dyst.
 Ai ban zhurme t'madhe
 Ai isht zenjin i mykun.
 Ai çohet me shtat sabaha.
 Ai ta nep kmishen i shtatit.
 Ai nuk shkon pa gja nej vedi.
 Ai flet hakun.
 Ai s'ka zhigla.
 Ai e ma fjalën.
 Ai nuk t'le n'rrenë.
 Ai ta çan përmenden n'tra (ta blen mallin krejt
 është i pa shpirt dhe dilinxhi i pa karakter)
 Mblodhi: Shyqyri Islam Smajli, Priftaj, Arbnesht, Krajë

Qesh e njesh

Fjalosja

-Pse ti me gruan fjalosesh gjithmonë në rrugë? - pyet njëri shokun e vet.
 Sepse gruaja ime kërkon qetësi në shtëpi.

Bisedojnë dy shoqe

-A e di se jam shtatzënë?
 Mrekulli, burri yt me siguri është gëzuar?
 -Ai as që di. Asnjëherë nuk i interesojnë punët e huaja.

Testamenti

-Sa po kërkoni për këtë 'Mercedes'?
 Pesë mijë dinarë.
 -E pamundur! Pse kaq pak?
 Burri im shkroi në testament që ta shes dhe paratë t'ia jap sekretares.

Qeshja

Njeriun me thikë në shpinë e sjellin në spital. Në repartin për raste urgjente një infermiere e re e pyet:
 -Oh, more i mjerë, a po të dhemb shumë?
 -Jo, vetëm kur po qesh, përgjigjet i plagosuri.

Përgatiti Shaban Hasangjekaj, Martinaj, Guci

Në Kosiq u bekua Kisha

Shkruan: Gjekë Gjonaj

"Rimëkëmbja e këtij objekti fetar të moçëm, i cili në dokumentet arkivore përmendet që në shekullin e XVI, u mundësua falë donatorëve nga farefisi Lulaj, miqve dhe shokëve të tyre", tha në meshën solemne dom Simë Lulaj.

Më 27 korrik 2008 u bekua Kisha e Shënkollit në fshatin Kosiq, Anë të Malit, rrethi i Ulqinit. Meshën e shenjtë e celebroi dom Simë Lulaj, i cili në praninë e besimtarëve katolikë dhe islamë, pasi foli për të kaluarën e kësaj kishë, falënderoi donatorët dhe të tjerët që kanë mundësuar rimëkëmbjen e këtij objekti të lashtë fetar. "Në oborrin e kësaj kishë kanë qenë varrezat e Lulajve. Aty janë varrosur disa besimtarë, kurse disa të tjerë edhe përjashta tij, emrat e të cilëve për fat të keq nuk dihen, pasi asokohe nuk ka qenë rregull të shkruhen në pllakën e varrit. Po edhe ata që e kanë shkruar emrin në pllakën e varrit shekujt kanë bërë që ata të shlyhen e të jenë të palexueshëm. Ndërkaq eshtrat e disa personave të varrosur në këto varreza janë transferuar në varrezat familjare në Kllezën Nalt", tha dom Sima. "Kisha asohere ka vendosur që disa njerëz t'i varros jashtë mureve të saj për shkak se ata nuk i kanë kryer ashtu si duhet obligimet e tyre fetare. Jashtë mureve të kishës janë varrosur ata që kanë bërë mëkat, si për shembull vrasësit. Dhe ata kisha për këtë vepër të shëmtuar i ka dënuar, duke mos i varros prifti. Me këtë disiplinë kishtarë është tentuar të zvogëlohet numri i vrasjeve.", u shpreh



pranishmit nga vende të ndryshme të komunës së Ulqinit me rrethinë dhe diaspora në këtë solemnitet rasti i përshëndeti dom Robert Jakaj, kurse në emër të besimtarëve islamë përshëndeti Ethem Mehani, me dëshirën që këtë objekt kulti ta gëzojnë të gjithë bashkëfshatarët e të dy konfesionëve, të cilët janë shembull për të tjerët për harmoninë fetare të trashëguar me shekuj.

Sima, duke shtuar se ata që janë varrosur brenda mureve të kishës janë konsideruar njerëz besimtar, fetar, kurse të tjerët si njerëz të pafe, jobesimtar. Sipas fjalëve të dom Simës, kjo kishë nuk do ishte rimëkëmbë pa kontributin e besimtarit të devotshëm të Zotit dhe fesë së krishterë, zotit Lekë Lulaj, i cili jeton në SHBA. "Ai duke qenë i pasionuar për vendlindjen e tij, inicioi dhe realizoi këtë vepër të madhe, e cila përherë do të jetë në shërbim të besimtarëve të fesë së krishterë katolike. Ai nuk kurseu mundin, kohën as xhepin që të sensibilizojë farefisin Lulaj, por edhe bamirësit e tjerë bujarë, miqtë e shokët e Lulajve që ndihmuan me para ndërtimin e kishës. Me kontributin e tyre financiar donatorët kanë ndërtuar rrugën prej rrugës kryesore deri te kisha. Fisi i Lulajve kanë kontribuar shumë edhe në ndërtimin e kishës në Kllezën Nalt dhe Kllezën Posht, çka tregon për interesimin e madh që kanë për kishën e tyre", nënvizoi Sima. Ai në vazhdim

f a l ë n d e r o i Rrahmanin dhe Metën Velijaj, të cilët kanë lëshuar shumë tokë nga pronat e tyre për rrugën e kishës, pastaj projektuesin e kishës, Gjergjin e Pjetrit Gjelij Dabaj, ndërtuesin e kishës, Elez Elezajn, Gjokë Shkrelin, furrën e bukës "Kodra" e të tjerët.

Më pastaj të

Lista e donatorëve për ndërtimin e kishës

Jakë Kola Lulaj	2000 \$
Martin Gjoni	3000
Gjergj Paloka	11.000
Nrekë Hila Lulaj	2500
Hilë Paloka Lulaj	5500
Simë Preçi Lulaj	4500
Mark Nika Lulaj	1000
Kolë Gjoka Lulaj	1000
Noc Paloka Lulaj	5500
Palë Pjetri Lulaj	2000
Lubo Pjetri Lulaj	3000
Ivo Kola Lulaj	200
Loro Nreka Lulaj	6500
Fran Gjertgji Lulaj	2000
Gjergj Toma Lulaj	100
Rrok Nreka Lulaj	1000
Lekë Jaku Lulaj	5500
Gorna Gjergji Lulij	500
Dragan Kola Lulij	30€
Lekë Jaku Lulaj	250
Jakë Kola Lulaj & familja	1600€
Noc Matia Gjonaj & familja	5000\$
Gjokë & Angjë Duraj	1000
Martinë Dedë Shkreli	1000
Simë Simolacaj	1000
Gjon Nreka Çotaj	500
Lubo Gjergji Koçaj	500
Marsh & Antoneta Lucaj	500
Nikë Palkola	500
Agustin Nreka Çotaj	300
Sandër Luviqi Çotaj	300
Simë Zefi Markiqi	300
Fran Shtjefën Çotaj	200
Gjustë Kola Mirdita	200
Mark Luka Lukoliq	200
Palë Shtjefën Çotaj	200
Tish Zefi Koçi	200
Vjeko Shtjefën Çotaj	100
Kolë & Leze Kalaja	400



Toponimet e Krythës

(U konsultuan *Luci i Pjetrit Gjelij* dhe *Palë Kolë Dabaj*. Nëntor, 2007.)

Mblodhi GJOKË DABAJ

Vazhdon nga numrin i kaluar

LËRÆ LUCËT, quhet edhe LËRÆ LEKS, si trashëgimtar i *Lucit*. Ndërtuesi i kësaj lere ka qenë LUC MARGJONI me prejardhje nga *Nënmali i Shestanit*. Për kureshtje po shënojmë që një pinjoll i kësaj familjeje, me të njëjtin emër e mbiemër, veçse pak të modifikuar, lindur e rritur në SHBA këtu e 50 vjet më parë, është zoti LUIS MARJON.

LËRÆ PRËÇNIKÄNJ, thuhet edhe LËRÆ PRËÇNIKÄNJVËT. Ndodhet në *Boka*. E ka ndërtuar *Nika i Preçit Niks*, si përshpirtnore për djalin e vet *Gjergjin*, i cili është vrarë, në *Jugosllavinë* e atëhershme, i mobilizuar prej forcave jugosllave, në luftë kundër nazizmit.

LËNJETHË, prone e rrethuar në pjerrësinë që quhet *Brinja e Malit*. Është e birësisë Margjonaj, me prejardhje nga nënmali i *Shestanit të Poshëm*. Duket se lidhet me kultivimin e lirit: Fillimisht mund të ketë qenë *LINIE-LINIA, pastaj ka marrë prapashtesën -TH, e cila është përdorur gjithandej në toponiminë tonë. Me kohë ka ndodhur edhe zhvendosja e theksit te E-ja, si në një shumicë fjalësh në gjuhën shqipe.

LËNJETHË LËKS STJEPS, njera pjesë e *Linjethit*, në krahun veri-perendimor.

LËNJETHË PÄLS PJETRËT, pjesa jug-lindore e *Linjethit*, pronë e pasardhësve të *Pals Pjetrit Nik Luks (Palës së Pjetrit të Nikës së Lukës)*. Ka qenë punuar në brezare, me mure në trajtën e izohipseve, me shumë hardhi e gjithfarë pemësh të tjera.


LËGÛ J BÛKÛR, një nga lugjet në *Mal të Krythës*, që zbret në drejtim të detit. Quhet *i bukur*, sepse nuk është i thelluar si të tjerët, as i gërryer, por karakterizohet nga forma të buta e të këndshme.

LËGÛ J FERRÄVËT, një nga lugjet e *Malit të Krythës*, i cili zbret paralel me të tjerët në drejtim të detit. Quhet *i ferravet* sepse në pjesën më të thelluar të tij rriten ferrëmana të shumtë, të cilët e vështirësojnë kalimin.

LËGÛ J KËRRQELËS, përrua i vogël në *Brinjë të Malit*.

LËGÛ J LLÄNISHTS, lug në *Mal të Krythës*, që fillon te *Llanishta* dhe zbret deri në det. Theksi është te I-ja me gjatësi të mesme, ndonëse në të njëjtën fjalë kemi një Ä buzore, labiale, që është më e gjatë se I-ja. Pra, theksi nuk bie përherë te zanorja më e gjatë.

LËGÛ J PËLËNAÇS, lug midis *Lams Gors (Lamës së Gorës)* dhe *Marvjanit*. Është në pjesën më jugore të *Malit të Krythës*. Më tutje gjendet vetëm *Bishti i Rrasës* dhe pastaj fillon *Ullishta e Ulqinit*.



Krytha e Ulqinit - një pamje

LËGÛ J RËZÄS, një zabel, pyll i vogël, pronë e *Rizait (Rizasë)*, i cili pat ardhur këtu si dhëndër, kollovar, në një familje që nuk kish djalë.

LËGÛ J SÛJMIRS, luginë sipër oqrajës, rrahinës, me emrin *Sojmirë*. Ndodhet thuajse në pjesën më të ngritur në *Mal të Krythës*.

LËGÛ J SHKALLÄVËT, lug në *Mal të Krythës* që zbret në drejtim të detit, ngjitur me *Lamën e Gorës*.

LËGÛ J SHLLINS, lug në *Mal të Krythës*. Si duket, ujët e detit, të shëllirët, mbetur nga dallgët nëpër pusët prej guri, e lëpinin bagëtitë.

LËGÛ J VËJUSHÄVËT, lug në pjesën perendimore të *Malit të Krythës*. Zbret në det në krah të gadishullthit që quhet *Bishti i Fushës*. Tërheq vëmendjen emërtimi, i cili sugjeron një ngjarje, ndoshta legjendë, të lidhur me gra të veja. Në fund të këtij lugu ka një gji të vogël, por shumë të përshtatshëm për plazh.

LLÄNISHTÄ, oqrajë, rrahinë, në *Mal të Krythës*. Në gjuhët sllavojugore LAN (LLAN) është *liri, lini*, bimë që mbillet për të prodhuar prej saj fije tekstili. Latinisht LANA i thonë *fijes së leshit*, kurse LINEA është *fije liri, fije lini*. Pra, toka në të cilën kultivohet *liri, lini*. Ndërkohë, na duket interesante zanorja Ä e labializuar dhe e zgjatur.

MÄDEMË, vend në perendim të *Linjethit*, ku duket që është kërkuar mineral në një shkuar jo të largët. Nxjerrjet kanë ngjyrë të kuqe, pas gjasës, të natyrës së feronikelit MADEM është fjalë turke me kuptimin *mineral*.

MÄJË HIJËS, majë në krye të pjerrësisë që quhet *Hije*. Është maja më e lartë në *Malin e Krythës*, prandaj dhe është përdorur për *banir*, tufë gjetesh mbërthyer në një shtyllë të lartë, shenjë që në traditën shestanase shërbente për të *njoftuar* se aty ka një vendbanim. Ky lloj *lajmërimi, njoftimi*, se aty ka një vendbanim, ka rëndësi të jashtzakonshme në

historinë e kulturës sonë kombëtare. Ai tregonte në radhë të pare integritetin e atij vendbanimi, tregonte paprekshmerinë, tregonte pronësinë, kolektive dhe vetjake, në fund të fundit, I tërhiqte vëmendjen kujtdo, qoftë edhe një ushtricë të huaj, që mund të kalonte rastësisht anej, të ketë kujdes, se ai vend nuk është pa zot. Shih edhe zërin BANIRI.

MÄLË KRYTHS, mal, pronë e *përbashkët* e fshatit *Krythë*, duke filluar me *Hijen* dhe duke pasur në krahun tjetër një numër lugjesh e kurrizesh që zbresin në det, i mbuluar me drurë përjetësisht të gjelbër, po edhe me lloje të tjerë drurësh, ai është *një nga kombinimet më të bukur të natyrës mesdhetare*. Mungon vetëm dora (e modernizuar, e specializuar) e njeriut, për të bërë aty *një mrekulli turistike*. Puna e parë që duhet bërë sa më shpejt, është *plani eko-urbano-turistik i krejt asaj hapësire*. Kuptohet, është i domosdoshëm edhe legjislatiioni përkatës, në mënyrë që të respektohet *pronësia tradicionale* mbi atë hapësirë. Unë po sjell këtu vetëm disa elementë, në formë skic-ideje, të atij plani. 1. Rrjet

rugësh. Jo vetëm anës detit, që është kërkesë e parë, por në të gjithë hapësirën, në mënyrë që krejt ai ambient të mund të vihet në shërbim të turizmit. 2. Vënia e krejt pyllit ekzistues nën një regjim ekologjik të specializuar, duke pastruar çdo shkurre që e pengon kalimin dhe duke lënë të rritet çdo dru që ia shton bukurinë krejt ambientit. Pa zbatuar një regjim të mirëfilltë mbrojtjeje, ruajtjeje e kultivimi të botës bimore ekzistuese, as që mund të pretendohet për ta shfrytëzuar këtë mal, për të cilin mund të thuhet pa frikë se 80% është i gatshëm për turizëm. 3. Ndërtim rezervuarësh për ujë, të quajtur ujëmbledhësa. Këta ujëmbledhësa, jo për larje, as për të pirë ujë prej tyre, por thjeshtë për ambient. Do të krijoheshin ashtu, duke marrë shembull nga lerat ekzistuese, liqene të vegjël apo pishina në të gjithë hapësirën dhe kjo do t'ia shumëfishonte vlerën krejt mjedisit. 4. Ndërtim hotelesh dhe ambientesh të tjerë për turistët, si gjatë gjithë vijës bregdetare, ashtu edhe në lartësitë e malit, nga ku i hapen vizituesit dhe pushuesit pamje nga më madhështoret. Vendësit, pra banorët e **Krythës**, do të merrnin pjesë në krejt këtë veprimtari si aksionerë natyralë, dmth. si **pronarë** të truallit ku zhvillohet një e këtille ekonomi moderne. 5. Plotësim i krejt vijës buzë detit me rërë të imët, prurë këtu prej **Plazhës së Madhe**, natyrisht, pa e dëmtuar atë. 6. Vetëkuptohet që e gjithë kjo duhet të paraprihet me rrjetet përkatës të ujësjellësavet, si dhe të rrymës elektrike.

MÁNĀT E BOKĀVĒT, disa mana në një djerr pranë **Prronit të Bokavet**. Përafërsisht në qendër të fshatit.

MÁNĀT E GUÇĪT, djerrinë dhe disa mana në **Brinjë të Malit**. **Guçi** thonë ka qenë pronar i dikurshëm në këtë fshat. Emri **Guç** është i paqartë.

MĀRĀNJT, lagje në luginën ku ndodhen edhe **Niklukanjt**, në verilindje të **Vorrevet të Krythës**, ku sot ndodhet shkolla.

MĀRJĀ, pyll me mare në pjesën veriperendimore të **Malit të Krythës**. Një pjesë e këtij pylli i takon edhe **Krruçit**, por duhet theksuar që ndarja aktuale kadastrale nuk është e rregullt. Kjo duhet të rishikohet e të korrigjohet.

Bima e **mares** ose e **koçimares**, në **Jugun tonë** i thonë edhe **mare** me theks te E-ja,

latinisht **Arbutus unedo**, sllavisht **planika** (pllanika) ose **maginja**, është e veçantë dhe tepër interesante. Në të vërtetë, **MĀRJĀ** është një pyll i madh e i pakalueshëm, i mbërthyer, veç tjerash edhe me një bimë kacavjerrëse që quhet **lapagreth**, por, nëse do t'i bëhej pastrami i nevojshëm dhe mirëmbajtja përkatëse, aty do të krijoheshin padyshim një ambient i rrallë dhe jashtzakonisht tërheqës.

MĀRKONĀ, kodër, në të cilën në fillim të shekullit XX është vendosur aparatura e teletransmetimit, shpikur prej shkencëtarit të njohur italian **Markoni**. Një toponim vërtet i respektueshëm, për shkak të historisë që mban me vete. Ndodhet në të njëjtën lartësi dhe paralel me **Majën e Hijes**.

MĀRVJANĪ, mal në vazhdim të **Malit të Krythës**, i shmangur dhe i spostuar pak më në jug. Greqisht **μαυρος** (mauros) do



Krythnjant çonin banirin në Mal të Krythës

të thotë **i murrmë, i zi**. (Mund të vërehet metateza.) Shqip, në Jug dhe ndër arbëreshë, përdoret fjala **mavri**, me kuptimin **i mjerë, i zi**. Prandaj prejardhja e këtij toponimi do studiuar me vëmendje. Në vazhdim të **Marvjanit** vjen **Mali i Bardhë**, pra i kundërt me **“të ziun”**. Si territor, **Marvjani** i takon **Braticës**.

MĀSKOPSHTJĀ, tokë që i takonte **Gjelit Nik Pjetrit** dhe tash është pronë e pasardhësve të tij. Ka kuptimin **mbas kopshtit**, pra është një rrethor vendi i substantivuar, i kthyer në emër.

MÖGILĀ, gur i vendosur prej njerëzvet në anë të rrugës që quhet **Rruga e Sojmirës**. Ka të ngjarë që aty të ketë pasur ndonjë varrezë të lashtë, tumulare, ose është ruajtur thjeshtë emërtimi me kuptimin **grumbull gurësh**.

MÖGILĀE HÛNĒS, mur në formën e cilindrit majë një kodërze afër **Radoçit**.

Emërtimi tërheq vëmendjen ndaj kohëve të lashta, kur këndeje kanë kaluar hordhitë shkatërruese të **hunëvet**. Aty mund të jetë varrosur ndonjë pjesëtar apo prijës i atyre **hunëve**. Por mund edhe të mos ketë fare lidhje me **hunët**. Në toponimi ka gjithëmonë rrezik të bëhen gabime në spjegim. Në fushën e fonetikës do vënë re **Ū-ja**, që është hundore dhe e gjatë. Ndërsa gjinia mund të jetë ndryshuar për të mos u njëjtësuar me emrin **HU**, **huni**, ashtu siç ka ndodhur me emrin e **Lezhës**, për të mos u njëjtësuar me **LESH**, **leshi**.

NĪKLUKĀNJ, lagje në pjesën lindore të **Krythës**. Janë me prejardhje nga **Nënmalit** i **Shestanit të Poshtëm**. Pranemri i tyre është **Margjonanj**, ndërsa **Nik Luka** duket se ka qenë i pari i këtyre i ardhur këtu në **Krythë**, ndryshe nga **Mark Gjoni**, i cili është i pari i tyre i mëhershëm. Të vihet re ruajtja e prapashtesës **-ANJ**, e cila sot në gjuhën shqipe përgjithësisht ka kaluar në **-AJ**.


ÖGRĀJĀE IVÖS, njera prej ograjave, rrathinave, të shumta që ka në **Malin e Krythës**. Është pronë e **Ivo Janinës**, pjesëtar i një vëllazërie të ardhur këtu, në kapërcyell të shekullit XIX, prej qytetit tonë jugor, **Janinës**. Kjo vëllazëri, duke qenë se është ortodokse, ka qenë ndër të parat familje shqiptare, e cila, bashkë me **Strugët** e

ndonjë tjetër, i ka hyrë rrugës së sllavizimit.

ÖGRĀJĀE HÛSS LĀKÛT, ograjë, rrathinë, në **Mal të Krythës**, pronë e pasardhësve të **Hysës së Lakut**, pjesëtar i një familjeje të myslimanizuar me prejardhje nga vëllazëria **Dabanj** prej **Shestanit të Sipërm**. Emri **Lāk**, si duket, vjen prej emrit **Ibrahim**, sepse ka qenë pikërisht një **Ibrahim**, i cili, pasi ka ndrruar fenë në **Gurrzë të Shestnit**, është ulur këtu në afërsi të **Ulqinit**.

ÖGRĀJĀE LATÖS, ograjë, rrathinë, mu pranë detit, në kufi midis **Malit të Krythës** dhe pjesës së po këtij mali, që i takon **Krruçit**. Ndryshe nga rrathinat e tjera, që janë të rrethuara me mur, megjë e thatë, kjo ka qenë e rrethuar me gardh. Shënojmë që **Lato** është shkurtim i emrit mysliman **Latif**.

MJEKIMI I SËMUNDJEVE KRONIKE ME FAKTORË NATYRORË NË RRETHIN E ULQINIT



Në punimin e vet, prim. Dr Gani Karamanaga merret me 7 faktorë natyrorë në rrethin e Ulqinit, të cilët mund të përmirësojnë shëndetin, ose edhe të shërojnë shumë sëmundje kronike. Këta janë uji i detit me ngrohtësinë e përshtatshme në kohën e verës, uji mineral sulfurik me temperaturë 14°C, kripa e detit me përqendrime të ndryshme, rëra e nxehtë me një radioaktivitet të lehtë, balta mjekuese me ndikim termik dhe kimik, kripa e butë e lëngshme prej kriporës së Ulqinit, si dhe klima e butë bregdetare mediterane.

Pra, janë këta të gjithë faktorët që mundësojnë zhvillimin e një

turizmi shëndetësor.

Në suaza të këtyre faktorëve, autori Karamanaga përmend edhe aktivitete të shumta rekreative. Sporti, notimi, shëtitja në bregdet nën pisha ose nëpër ullishtë, rrezatimi në diell, janë faktorë që e rrisin imunitetin e organizmit, mund të parandalojnë shfaqjen e sëmundjes, të përmirësojnë ose edhe të shërojnë sëmundjen, si dhe të shpejtojnë rehabilitimin e të sëmurit. Të gjithë këta faktorë natyrorë mund të shfrytëzohen gjatë krejt vitit.

Këta faktorë mund të jenë të dobishëm për mjekimin e sëmundjeve kronike gjinekologjike (posaçërisht steriliteti parësor dhe ai dytësor), për rehabilitimin mbas intervenimeve kirurgjike, për mjekimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve të sistemit lokomotor, si edhe për disa sëmundje nervore dhe psikike, për mjekimin dhe rehabilitimin e disa sëmundjeve të lëkurës (duke përfshirë këtu edhe sindromën varikoze pa varra), për mjekimin e astmës dhe sëmundjeve pulmonare obstruktive kronike, pastaj të organeve gastrointestinale dhe të gjëndrës tireoide.

Autori Karamanaga është marrë kohë të gjatë me mjekimin e astmës bronkiale dhe të sëmundjeve pulmonare obstruktive kronike. Ai vërteton që mikroklima e trevës së Ulqinit paraqet një faktor shumë të rëndësishëm, ku gati gjatë krejt vitit mund të aplikohen faktorët natyrorë për mjekimin dhe parandalimin e këtyre sëmundjeve. Këtu posaçërisht ndihmon aerosoli, i pasur me ozon, oksigjen, jod, natriumklorid. Aerosoli krijohet gjatë shpartallimit të tallazeve nëpër shkëmbinj. Aktivitetet rekreative nuk i ndalohen të sëmurit. Astma dhe sporti mund të qëndrojnë së bashku.

Në bazën e të dhënave të autorit, lirisht mund të thuhet, që faktorët natyrorë të Ulqinit, si terapi plotësuese e asaj medikamentoze, e lehtësojnë dhe e përmirësojnë astmën bronkiale, si dhe sëmundjet pulmonare obstruktive kronike.

Dhe në fund një porosi. Ideja e autorit për zhvillimin e turizmit shëndetësor në Ulqin duhet të përkrahët prej të gjithëve, e sidomos prej atyre në pozita vendimmarrëse.

Prof. Dr **Simë Gjon Dobreci**

BARKA ME VISARE

Hajro Ulqinaku: Barka me visare, botoi Asociacioni ULQINI, Ulqin 2008, faqe 128.

Ende nuk ka mbaruar viti kalendarik dhe nga Asociacioni Ulqini nga Ulqini doli në treg dhe një libër me shumë rëndësi e i cili është i pesti me radhë këtë vit.

Bëhet fjalë për botimin e tretë të *Barkës me visare* të autorit të mirënjohur nga Ulqini, z. Hajro Ulqinaku

Barka me visare siç thotë edhe vetë autori është një përmbledhje personale me tregimet më të bukura të cilat ia ka kushtuar detit dhe vendlindjes, fakt ky i pamohueshëm pasi që ky libër edhe është i parashikuar si lekturë shkolllore për klasën e VI të shkollës fillore të reformuar.

Libri përmban 25 tregime me motive nga deti e që padyshim se janë shumë joshëse për lexuesit tanë të vegjël. Autori njuh mirë jetën e njerëzve të bregdetit e veçmas shpirtin e etur të fëmijëve kureshtarë të etur për tema me motive dhe ide nga deti, bregdeti, ishujt, thesaret, piratët, peshkimin, ullishtat mijëvjeçare. Që të jetë sa më i këndshëm dhe më i kapshëm për lexuesin libri përmban edhe një fjalorth terminologjik të fjalëve lokale të cilat fliten në Ulqin e që kanë të bëjnë për detin dhe objektet rreth tij.

Libri i këtitillë padyshim se është një pasuri e madhe për letërsinë shqipe. Ai paraqet plotësim sado të vogël në zbrazësinë e krijuar në mungesë të mjeteve mësimore e posaçërisht të lekturës shkolllore.

Gazmend Çitaku



Veip PRODA

TROJET ETNIKE

Kosova

Hallemadhe-ballëndritur,
e tendosur e përzhitur,
e sulmuar e goditur,
si askurrë e përgatitur.

Shkupit

Scup-Skup-Skip-Shqip,
S'hup-s'humb-s'hik-s'ik,
S'heq-shiqet-shidhet-s'hiçet,
S'shkon-s'shkilet-s'piqet'digjet!

Ulqinit

Ky Ulqini një kala,
shqiptar krejt jetën pa pra,
një Flotë Ndërkombëtare në det,
të qëlloi vaj medet,
tregon historia vetë,
në Crna Gora me mbet,
por s'ka forcë nuk ka shtet,
më mizori të jetë,
t'ia largojë e t'ia tret,
ndjenjën për nënën e vet!

Janinës

Janinës ç'i panë sytë,
s'i panë pak i panë shumë.
Në fillim thikën e krimit,
më pas shpërnguljen me dhunë!

Ilirida

Ilirida-Iliridë!
Nga Antika vjen përditë.
Dihet je në Ilirí,
ndryshe quhesh Shqipëri.

Prishtinës

Ku Ulpiana jonë u prish,
në Antikë në heresi.
Prishtinë ajo u quajt,
e gjallë në histoti.

Shqipëri

Shqipëri katër vilajete,
një e katërta sot mbete!
Copa-copa ty të ndanë,
në gjashtë shtete trojet janë.

*Marrë prej revistës KUVENDI 2,
maj-qershor 2007:26.
Zgjedhi prof. Dr Mentor Disha,
Prishtinë, më 21.10.2008.

MORI KRAJA NËN RUMI

Mori Kraja nën Rumi
Ku të ikën gjin'ja ty
N' Amerikë të ikën ty
Jo ma pak se katër mi
Katër mi e pak ma shumë
Po sa janë tjetër kund
Heret¹ n'Shkodër shumë kanë
dalë²

Në Ulqin edhe n 'Tivar
Shkuen n' Francë e n' Itali
N'Gjermani e n'Suedi
Në Zvicerr e n'Austri
Në Belgjikë, në Australi
Kanë metë shkollat me pak fëmi
Kanë fillue edhe mu **ndry**³
Kanë mbet nanat me lot n'sy
Kanë met bijat pa gjini
Vjen Bajrami ardhhtë i bardh
Nuk po ka kush me na ardhë
Ata prej qefit s'kanë shkue
Ktu isht zor o me jetue
Punon shumë e të del pak
E para kohet mu plakë
Po një gja s'isht mirë n'gurbet
Që harrojnë gjuhën e vet
Prej merzisë knova kët kangë
Kjoshin mirë kudo qi janë.

1.Heret - dikur, 2.dalë ikë, migrue, 3.ndry - mbyllë

Këndoi: Nuriya Elezit Muhas-Hardoj, e shoqa
e Fadil Imerit Mehmetit-Lubana, amvise 50
vjeçare, Skje (Kranjë).
Shenoi: Ali Gjeçbritaj

Skender Beqiri

HEJ MOJ ÇAMËRI

Me nënën bashkë rrimë në odë
Diçka belbëzon në këngë e qetë
Kujtim të thellë shpirti ka
I dalin ngadalë nga një "Han" i vërtetë
E nis vargun e këngës së hershme
Me trimat e Çamërisë Martire
Sytë i përloten nga koha e djeshme
Mrekullia balade, në gojë përpëlite
Eh moj Çamëri, me vatha mes këputur
Lloj, lloj tominesh, ngjyrë ylberi
Me djem kalosha si flutur
Me za liria si krisma maliheri
Rrjedhin vitet si lumthi Kalama
rënkon vatani jaram te Gurët e Zezë
Mbi shpinë shumë halle të rënda mba
Sytë e nënës mbeten me shpresë

MALL E BRENGË PËR ÇAMËRINË

Çamëri Çamëri!
Bukur tingëllon kjo fjalë
Dhe në zemrën time
Ndez një zjarr të madh
Çamëri e dashur
Ty kur të kujtoj
Mall e brengje ndjej
Kur të shikoj
Mallin që na djeg në shpirt
Për Çamërinë tonë
Asgjë nuk e shuan
Veçse kthimi jonë....



Kalaja e Ulqinit, gravurë 1573

More Lena pinçanjore

More Lena pinçanjore,
 Ç'e bâne burrin qi more?!
 'Un e nisa për mulli,
 Me tri kokrra mel të zi.
 Nenj tri dit e nenj tri net,
 Prit e prit e nuk më erdh'.
 Vuna furkën-o në brez
 E u nisa shkova vetë.
 Râshë e shkova në mulli:
 Ç'bân këtu, he qen, he thi?!
 Shtiva miellin në thes,
 Burrin e lidha për brez.
 E pruna, e vuna n'votër
 E m'u duk si kuc i vogël.
 E kapa e çova n'kâmë,
 E m'u duk si qen pa dhâmë!
 Kapa, vuna shenj mas arket,
 M'ja hangri mini mustakët!
 E kapa e çova në trâ
 E m'u duk si prithi shkjà!

Këndoi Mrika Margjonanj,
 shtja² Gjonit Pals Pjetrit,
 shestaneshë prej Krythës,
 Ulqin, më 1960.

Marrë prej Gjokë Dabaj,
Shestani (vëllimi I), Ulqin-
 Tiranë-Prishtinë 2004:581.

1. Shestanasit* në vend të dh përdorjnë ll.

2. Shtja shortja, bashkeshortja.

*Shestanasit shqiptarë me banim ose me rranxë në Shestan, Pinç, Ljare, Brisk ose Thtjan (pjesa perëndimore e Kranjës, në jug-perëndim të Liqenit të Shkodrës, rrethi i Tivarit).

Popullore nga Çamëria*

Spatari në Mal të Bregut

Spatari, në Mal të Bregut
 Fshat i bukur si ai
 Filatin për nën vehte
 Korfuzin për karshi
 Erdhi Zerva i vu zjarre
 E dogji e bëri hi
 Shtatëdhjet' e ca të vrarë
 Gra pleq e çilimi
 Seç i theri porsì shqerra
 Se s'mohuan kombësi
 Thanë - Jemi Shqipëtarë
 Si në gjithë Çamëri
 Me Grekër duam të rrojme
 Në paqe e në miqësi
 Çamëri o zemra ime
 Çamëri o zemra ime
 Vend i bukur plot kujtime
 Pse o xhan, mbete jetime?
 A mos vallë pate gabime?
 As gabime as të metë
 Dëshmon historia vetë
 Çamëri o vend thesar
 Ke ke sot trashëgimtar
 Fol! pse të verboi loti?
 Ke me lakmoi qysh moti!
 Çamëri, me plot lëndina
 Ku këndonte gjeraqina
 Ku të shkon sot bagëtia
 Disa i merr mbretëria
 Të tjerat Katileria
 Që të mbahet qetësia

*Marrë nga libri i **Fatos Mero Rrapajt**

Oj syzezë

Oj syzezë, vetull-kunorë,
 ku m'ke kjenë e qi je lollë*?
 Puntore kam kjenë me korrë,
 me drapën preva nji dorë.
 Dora lillun-o me rizë,
 syn'i zi po shkon për fis.
 Bjeri hollë-o në mjedis,
 bjeri hollë, mos u mërzit,
 se je vogël te u rritë,
 hala drapnit s'je vadit.
 Ti ke dashë-e me shpejtuo,
 me mujtë shoqet me kaluo,
 masanej e me t'ullduo.
 Rri djal-o, mos qesh me muo,
 se s'kam dashë e me shpejtuo,
 masanej e me m'ullduo,
 disi drapni m'u gatruo
 e ma prev e dorën muo.

*Shestanasit përdorin ll në vend të dh. Shestanasit shqiptarë me banim ose me rranxë në Shestan, Pinç, Ljare, Brisk ose Thtjan (pjesa perëndimore e Kranjës, në jug-perëndim të Liqenit të Shkodrës, rrethi i Tivarit).

E shënoi Stjepa'j Zefit Stjeps Niks,
 shestana i familjes Dabaj, me rranxë
 prej Gurze, Shestani Naltë, rrethi i
 Tivarit, tash në Krythë, Ulqin, më
 1.11.2008.

Kangë lirike e Plavë-Gucisë

1. Mori e mira ç'i shkon me lopë

Mori e mira ç'i shkon me lopë,
 Kah po i çon, kah po i kullot?
 Njati shpati, njasaj gropë.
 A ke peçe, a ke flokë?
 As s'kam peçe, as s'kam flokë,
 Kam dy molla përmi shokë.
 Përmi shokë e nar jelek,
 Ruej kopil e mos m'i prek,
 Se me i prekë qesin sherbet.
 Ky sherbeti fort i amël,
 Si me hangër pshesh e tamël.
 Pshesh e tamli pika pika,
 Krisi reja, ra nër çika,
 Nja ma t'mirën e grabita,
 E ma t'keqen e shkelmita.

Shënoi **Shaban Hasangjekaj**

Lypësi

Një lypës ankohet se është i uritur. Kalimtari ia jep disa para:

-Vetëm mos pini me këto para, por bleni diçka për të ngrënë.

-A mos po iu këshilloj unë si t'i shpenzoni paratë tuaja, u hidhërua lypësi.

Përgatiti

Shaban Hasangjekaj,
 Martinaj, Guci



*Mrika Gjoks Zefit dhe
 Mrika Niks Zefit në pazar
 të Ulqinit më 1947.*

Njoftim jo i mirë prej Nju Jorkut

From: Bruno <turbocro@verizon.net>
To: fdobreci@t-com.me, fdobreci@cg.yu
Date: Monday, November 24, 2008 03:38 pm
Subject: Re: Lajme te zeza

Bruno Bailo, i lindun në Amerikë, për ndryshe Arbanas i Zadrës (Kroaci) dhe me rranxë Shestanas, me preku me këtë shkrim të tij në gjuhën shqype:

Shumë i nderuami z. Sima,

Me vjen keq se nuk ju kam shkrua qysh kur, por gati për një muaj Gjyshja Violeta është sëmu keq. Pardje heret në natje, ka vdekë në 95-in vjet jetës. Ka kjenë në shpital qysh 12.XI.2008, e është dukë se u ka m'u shendosh der të Hanën, kur fati ka fillua me ndërrua në zi. Ashtu kemi mbetë me zembrat e randa.

Pak pej jetën e Gjyshes:

Është le në 14.V.1913 në Arbënesh (Arbanas, Zadër). Në të tretën vjetë shkollës, prindër e kanë hjekë për me ndimua familijes fushat m'i punua. Shumë ka durua në kohë të luftit dhe ma vonë ka ikë në Itali në kampat refugjeve për disa vjet. Ka ardhë në Amerikë ka 64 edhe prapë ka punua në fabrikën rrobesh, der ka mujtë. Me gjithëse ka pasë vikun te rande, dhe shkolla te vogëla, ka kjenë shumë e urtë e e vijeshme. E ka bashkua familijen edhe ka kjenë m'e para me kecyije kur ka duhe ndihm. Identitetin Arbenesh (Arbanas) kurr s'e ka harrua, e

g'juhën e ka ditë me fol ma mirë se të gjith. M'u ka lanë nder me kjenë Arbënesh e dashnijen për atdheun. Ka kjenë si lulja në maje të malit, e bukur por e duroshime. Po dërgoj dy foto Gjyshes: një foto pej festen e ditelindjes, dhe tjetren ne festë me sternipat Marko dhe Gjovani. Past dritë Gjyshja, kurr s'te harroj!

Falmeshendet tanve ne shpi,

Bruno Bailo

*Të parët e Bruno Bailos më 1726 erdhën në Zadër prej Shestanit (jug-perëndim i Liqenit të Shkodrës, rrethi i Tivarit).



Shestanasit* thonë (5)

Bardh si bora.
 Bërtet n'kupë t'qiellit.
 E ká gjetë kupa kapakun.
 Fet e fanî.
 Fle si i dekun.
 Fle si gurriq (derr).
 Ha' si qeni.
 Hyp e del e duku.
 Inati - bark thati.
 I ra n'lule t'ballit.
 I ra t'fiktë.
 Isht bâ si t'kish hângër gjânë e kishsë.

Isht bâ si t'kish hângër gjânë e mirisë.
 Isht n'ethe.
 Isht ny (lye)si thiu.
 Ja ka pi sorra mentë.
 Jena (afër me moshë), ikë se t'zuna.
 Kush i ra, i doli.
 Mé kërrkue me xhin-milet.
 Mo Zo' ma keq.
 Pa pritë e pa kujtue (gand).
 Plasa si kangalla.
 Po'j ban naze.
 Po m'preken n'erz.
 Po m'vjen qyryf (gërdi).
 Po shtjell moti.

Pse me bâ ish pa pasë pula.
 Punon si dhevla.
 Qesh e njesh.
 Sá me lá gojën.
 Sá për sy e faqe.
 Sá zogj (fëmijë) i ke?
 S'e ke kryet për dy kâmë.
 Si n'kohën e Ballhut's
 Si n'kohën e Xhenevizit
 S'isht gjâ sit.
 S'isht gjâ sojet.
 S'ka birë nânet qi ja kalon.
 S'ka burrë qi ja kalon.
 S'ka zog nânet qi ja del.

Mblodhi Simë Gjon Dobreci



Qypi prej gurit në Ulqin e Tivar ishte enë për vaj ulliri

Ndihmuan revistën Buzuku 28

(renditja si mbas abecedës)

Lubi Zefit Nreks Niks Pjetërgjon-
 Nilaj, Braticë, Ulqin 100€
 Mifit Jakupi & Hajro Shabani,
 AGRO-FARMA, Ulqin 40€
 Stjepa i Niks Stjeps Zefit
 Pjetërgjon-Nilaj, Braticë, Ulqin,
 tash n'Bern, Zvicër - 100€
 Vasi Zefit Nreks Niks Pjetërgjon-
 Nilaj, Braticë, Ulqin 50€
 Zefi Niks Leks - Brisku,
 Kullomzë, Ulqin, 20€

Ndihmuan shpërndarjen e Buzukut
 Anti Kols Gjeks Pjetër Hirit Rudaj,
 Shtoj, Ulqin



Granit Simon

**ME TRADITË SHUMËVJEÇARE PUNOJMË:
VARREZA, NISHANE, ENTERIJERË
PREJ MATERIALEVE KUALITATIVE
GRANIT E MERMER**

Robert & Nikollë Simonaj
pronarët

☎ **085/411-259, 069/022-854, 069/444-640**
nsimonovic@cg.yu

VETERINUM
1997



VETERINUM

Nëna Terezë p.n. 85360 Ulqin
Tel. 085/412-763, 401-412, 401-413, Fax: 085/401-413
Mob. 069 327 563, e-mail: veterinum@cg.yu

Barnatorja - Tivar: 085 318-124
Qendra për mbarrësimin artificial Ostros: 069 331 573
Ambulanca e Veterinerisë Katërkollë: 085/459-214

**Me gëzime
festat
e fundvitit**